

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6015
E martë, 3 mars 2020
çmimi 0.40 €

Meta paralajmëron firmosjen e dekretit për shpërndarjen e parlamentit



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

SOT (E MARTË) FILLON FUSHATA ZGJEDHORE NË KOMUNËN E PODUJEVËS
PËR ZGJEDHJET E JASHTËZAKONSHME PËR KRYETAR KOMUNE

RUDARI, BULLIQI DHE FETAHU

NISIN GARËN PËR KRYETAR KOMUNE



Sot (e martë) fillon fushata zgjedhore në Komunën e Podujevës për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar komune e cila do të zgjasë deri më 13 mars. Në garën për kryetar komune janë vetëm tre kandidatë: Nexhmi Rudari (LDK), Shpejtim Bulliqi (LV) dhe Naim Fetahu (PDK). Të hënën KQZ-ja ka hedhur shortin për renditjen e kandidatëve për kryetar të Komunës së Podujevës. LDK-ja do të ketë numrin 11, PDK-ja numrin 10 dhe LV-ja numrin 12. Të tre kandidatët për kryetar komune në Podujevë kanë folur për gazetën "Epoka e re" dhe kanë dhënë arsyet pse qytetarët e Podujevës duhet t'i votojnë ata në zgjedhjet e 15 marsit



IKShPK-ja: Në Kosovë nuk ka koronavirus

KUVENDI I KOSOVËS KA MBAJTUR SEANCË TË
JASHTËZAKONSHME PËR TAKSËN NDAJ SERBISË
DHE BOSNJË HERCEGOVINËS

Debat i ashpër në mes të pozitës dhe opozitës për taksën ndaj Serbisë

Subjektet politike as të hënën në Kuvendin e Kosovës nuk kanë arritur një qëndrim të përbashkët për taksën ndaj produkteve serbe. Për disa orë pozita dhe opozita kanë polemizuar për këtë çështje duke prezantuar qëndrimet e

tyre për dhe kundër heqjes së taksës. Partitë kanë kërkuar unitet për taksën dhe dialogun me Serbinë, por asnjë prej tyre nuk ka treguar gatishmëri për një gjë të tillë. Në debatin e gjatë parlamentar vetëm AAK-ja ka kërkuar

mbajtjen e taksës, kurse LDK-ja, PDK-ja dhe Nisma kanë kërkuar që kjo çështje të bëhet siç po kërkon ShBA-ja. Ndërsa kryeministri Albin Kurti ka prezantuar planin e tij për heqje të pjesshme të taksës



OPINION

GABIMET E POLITIKËS SHTETËRORE NDAJ TURIZMIT NË KOSOVË

Shkruan: Erzen
GJONBALAJ



AKTUALE



FILLON PROCESI I DEKLARIMIT TË PASURISË SË ZYRTARËVE TË LARTË PUBLIKË

KURTI U SHKRUAN LETËR PRESIDENTIT TRUMP DHE SEKRETARIT POMPEO PËR TAKSËN DHE DIALOGUN

EKONOMI

AGJENCIA KADASTRALE DHE POSTA NISIN BASHKËPUNIMIN PËR PËRDORIMIN E ADRESAVE ZYRTARE

ZVICRA, VENDI MË I SHTRENTJË NË BOTË, KOSOVA, E 124-ta



SPORT

GASHI: MBIJETESA NUK DISKUTOHET

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht-Tetovë
Curez-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Thaçi dhe Vuçiqi në Shtëpinë e Bardhë

PRISHTINË, 2 MARS – “Zëri i Amerikës” mëson se presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dhe ai i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, janë takuar të hënën në Shtëpinë e Bardhë. Edhe pse nuk është e qartë se në çfarë formati janë takuar ata, por më herët ishte paralajmëruar që presidenti serb do të pritej nga këshilltari i Sigurisë Kombëtare, Robert

O'Brien. Të dy presidentët ndodhen në Shtetet e Bashkuara në vizita të ndara gjatë të cilave zyrtarët amerikanë kanë kërkuar që të dyja palët të ndërmarrin verime që sigurojnë rifillimin e bisedimeve për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet tyre. Zyrtarët amerikanë po i kërkojnë Kosovës që t'i heqë tarifën e vendosura në nëntor të vitit

2018 ndaj mallrave serbe, ndërsa Beogradit i kanë kërkuar t'i japë fund fushatës për tërheqjen e njohjeve të pavarësisë së Kosovës. Brenda më pak se një muaji Shtetet e Bashkuara siguruan dy marrëveshje ndërmjet palëve për vendosjen e linjës ajrore, asaj hekurudhore dhe ndërtimin e autostradave ndërmjet të dyja vendeve.



Meta paralajmëron firmosjen e dekretit për shpërndarjen e parlamentit

Presidenti Ilir Meta, para me shumë se 100 mijë qytetarëve që morën pjesë në manifestim, tha se herën tjetër do të firmosë dekretin e shpërndarjes së parlamentit puçist, nëse pas miratimit të reformës zgjedhore nuk do të kishte reflektim nga ana e mazhorancës

TIRANË, 2 MARS – Në miting madhështor të hënën në Tiranë, në fjalën e mbajtur para me shumë se 100 mijë qytetarëve që morën pjesë në manifestim, presidenti Ilir Meta deklaroi se herën tjetër do të firmosë dekretin e shpërndarjes së parlamentit puçist, nëse pas miratimit të reformës zgjedhore nuk do të kishte reflektim nga ana e mazhorancës.

Reforma zgjedhore është planifikuar të miratohet më 15 mars dhe pas kësaj date pritet që të shpallen zgjedhjet e parakohshme nga ana e kryetarit të Shtetit. Pjesëmarrja ishte e jashtëzakonshme dhe fjala e presidentit Meta ishte madhështore, çka ndezi krejt Bulevardin kryesor në Tiranë. “Kur rrëzohen institucionet, ngrihet populli!- ishte thelbi i fjalimit të presidentit.

Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, pasi që ka firmosur dekretin kundër ligjit që i hoqi atij kompetencën për betimin e gjyqtarëve të rinj kushtetues, ka paralajmëruar edhe firmosjen e dekretit për shpërndarjen e parlamentit.

Ai tha se do ta bëjë këtë por në një datë tjetër.

“Përpara se të firmos dekretin kundër ligjit antikushtetues kërkoj shprehjen e vullnetit tuaj kush është pro, ju lutem të ngrejë dorën.

Vdekje e grushtit të shtetit, rroftë republika. Këtu paska një kërkesë tjetër nuk kënaqen me pak, nuk kënaqen me pak duan që sot shpërndarjen e parlamentit puçist.

Ju lutem më duhet të firmos këtë dekret dhe do të kthehem përsëri këtu për atë dekretin tjetër që e brohoritët më shumë” tha presidenti Meta.

Ilir Meta në fjalën e tij në tubimin e thirrur kundër mazhorancës, ka thënë se ai si president përulet vetëm para flamurit dhe para popullit.

Ai ka hedhur sulme ndaj mazhorancës si dhe ndaj ndërkombëtarëve duke i quajtur “puçistë” që kërkojnë sipas tij të shkatërrojnë sovranitetin e kushtetutës.

“Zëri i popullit, zëri i Zotit. Presidenti i popullit “kuq e zi” ulet në gjunjë, ulet në gjunjë vetëm para flamurit kuq e zi, para popullit të shqiptonjave.

Këtë ta dëgjojnë mirë puçistët vendas dhe organizata ndërkombëtare mafioze që



kërkojnë të shkatërrojnë sovranitetin dhe kushtetutën tuaj.

Neni dy i Kushtetutës që ju votuat në referendum në 22 nëntor 1998 thotë sovraniteti në republikën e Shqipërisë i përket vetëm popullit”, tha Meta.

Presidenti Meta ka ashpërsuar gjuhën dhe thirrjet, duke thënë se kur institucionet bien është koha që të ngrihet populli.

Sipas Metës, Shqipëria sot është ndarë në dy botë në atë të popullit dhe në atë të tradhtarëve. “Ndaj ju kam ftuar jo si Ilir Meta, por si presidenti juaj, si i vetmi institucion demokratik që ka mbetur në këtë shtet.

Për të dëgjuar zërin tuaj, sepse

kur institucionet bien, ngrihet populli dhe populli nuk futet në xhep si paratë e oligarkëve.

Jemi këtu sepse Shqipëria e sotme është ndarë në dy botë.

Në botën e popullit kuq e zi dhe në grupin që përfaqëson një botë të vogël të errët meskine egoiste dhe tradhtarë të puçistëve dhe të oligarkëve.

Që si shushunja pinë çdo ditë gjakun e popullit tonë me koncesionet e frikshme”, tha Meta.

Manifestimit të thirrur nga presidenti Meta, i është bashkuar edhe lideri i Partisë Demokratike, Lulzim Basha.

“Mesazhi im është një falënderim nga zemra për gjithë

qytetarët që i janë përgjigjur thirrjes për të mbrojtur Kushtetutën dhe një citim i një prej baballarëve themelues të ShBA-së Thomas Jefferson: e vetmja garanci për ruajtjen e lirisë është mbrojtja e Kushtetutës dhe se liria dhunohet, kur Kushtetuta shkelet”, tha Basha gjatë komunikimit me gazetarët.

“Në Shqipëri, Kushtetutës i ka mbetur vetëm kapaku. Mendoj se kriza politike duhet zgjidhur një orë e më parë për Shqipërinë dhe shqiptarët dhe se e vetmja zgjidhje janë zgjedhjet e parakohshme parlamentare në një ditë me zgjedhjet legjitime vendore”, tha Basha.

Komisioni Evropian rikonfirmon hapjen e bisedimeve me Shqipërinë

BRUKSEL, 2 MARS - Komisioni Evropian ka rikonfirmuar të hënën rekomandimin e tij pozitiv për hapjen e bisedimeve për anëtarësim me Shqipërinë. Komisioni ka hartuar një raport të ndërmjetëm i cili pritet t'u shërbejë si një bazë e re vlerësimi vendeve anëtare, në mbledhjen e Këshillit Evropian në fund të

këtij muaji, ku me gjasë do të diskutohet sërish tema për hapjen e bisedimeve për anëtarësim, ndërkohë që do të miratohet dhe metodologjia e re e prezantuar muajin që shkoi.

“Në dritën e progresit domethënës të arritur dhe përmbushjes së kushteve të përcaktuara njëzëri nga

Këshilli, në qershor 2018, Komisioni rekomandoi në paketën e tij të zgjerimit 2019 që Këshilli t'i hapë negociatat e pranimit me Shqipërinë. Në përgjithësi, Shqipëria ka rritur përpjekjet e saj dhe ka pasur rezultate të mëtejshme të prekshme dhe të qëndrueshme në fushat kryesore të identifikuar në përfundimet e Këshillit të

qershorit 2018. Si rrjedhojë, bazat e rekomandimit të Komisionit për vitin 2019 për t'i hapur negociatat e pranimit me Shqipërinë mbeten të vlefshme”, thuhet në raport.

Në mbledhjen e tetorit të Këshillit Evropian, presidenti francez Emanuel Macron vuri veton duke lënë pezull shpresat e Shqipërisë dhe



Maqedonisë së Veriut për hapjen e bisedimeve për anëtarësim, ndërsa kërkoi një rishikim të procesit të bisedimeve dhe vetë zgjerimit.

Sot (e martë) fillon fushata zgjedhore në Komunën e Podujevës për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar komune

Rudari, Bulliqi dhe Fetahu nisin garën për kryetar komune

Sot (e martë) fillon fushata zgjedhore në Komunën e Podujevës për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar komune e cila do të zgjasë deri më 13 mars. Në garën për kryetar komune janë vetëm tre kandidatë: Nexhmi Rudari (LDK), Shpejtim Bulliqi (LV) dhe Naim Fetahu (PDK). Të hënën KQZ-ja ka hedhur shortin për renditjen e kandidatëve për kryetar të Komunës së Podujevës. LDK-ja do të ketë numrin 11, PDK-ja numrin 10 dhe LV-ja numrin 12. Të tre kandidatët për kryetar komune në Podujevë kanë folur për gazetën “Epoka e re” dhe kanë dhënë arsyet pse qytetarët e Podujevës duhet t’i votojnë ata në zgjedhjet e 15 marsit

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

Podujevë, 2 mars - Sot (e martë) fillon fushata zgjedhore në Komunën e Podujevës për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar komune, e cila do të zgjasë deri më 13 mars. Në garë janë vetëm tre kandidatë: Nexhmi Rudari (LDK), Shpejtim Bulliqi (LV) dhe Naim Fetahu (PDK). Ndërkaq të hënën është hedhur shorti për renditjen e kandidatëve për kryetar të Komunës së Podujevës.

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) do ta ketë numrin 11, Partia Demokratike e Kosovës (PDK) numrin 10 si dhe Lëvizja Vetëvendosje numrin 12.

Kryetarja e KQZ-së, Valdete Daka, ka thënë se institucioni që drejton ka bërë të gjitha përgatitjet për zgjedhjet e jashtëzakonshme në Podujevë. “Ftoj të gjitha subjektet politike të cilat janë pjesëmarrëse në këto zgjedhje, kandidatët e tyre, vëzhguesit dhe të gjithë ata që janë pjesë e zgjedhjeve në Komunën e Podujevës, ta respektojnë Kushtetutën e Kosovës, t’i respektojnë ligjet në fuqi dhe rregulloret e KQZ-së”, ka deklaruar Dakaj.

Të tre kandidatët për kryetar të Komunës së Podujevës kanë folur për gazetën “Epoka e re” për këtë garë, duke dhënë edhe arsyet pse ata duhet të votohen nga qytetarët e Podujevës.

Kandidati i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) për kryetar të Komunës së Podujevës, Nexhmi Rudari, është shprehur i bindur në fitoren e tij më 15 mars. Ai ka thënë për gazetën “Epoka e re” se edhe në këtë mandat do të vazhdojë qeverisja e Lidhjes Demokratike të Kosovës në këtë komunë.

Rudari ka thënë se pret që këto zgjedhje t’i fitojë qysh në raundin e parë. “Ne synojmë dhe do të përgatitemi që ta

fitojmë këtë garë pa balotazh dhe ta vazhdojmë qeverisjen e Lidhjes Demokratike të Kosovës në Komunën e Podujevës. Pra, presim që këto zgjedhje t’i fitojmë qysh në raundin e parë”, ka thënë Rudari.

Ai ka vlerësuar se elektorati i LDK-së në këtë komunë është stabil. Sipas Rudarit, kushdo që mendon se ky elektorat ka lëvizur, gabon. Duke iu përgjigjur pretendimeve të kandidatit të LV-së për kryetar të kësaj komune, Shpejtim Bulliqi, i cili ka thënë se kjo komunë nuk është më bastion i LDK-së, Rudari ka thënë se forca e votuesve të LDK-së do të shihet më 15 mars. “Pretendimet e tij janë mendime të tij. Ajo që mund të them unë është se Bulliqi do ta provojë forcën e LDK-së tash në garën që do ta kemi më 15 mars. Do të shohë Bulliqi se elektorati i LDK-së në këtë komunë do t’i qëndrojë besnik Lidhjes Demokratike të Kosovës, kurse ai do të pretendojë të marrë vota nga subjekti që e ka propozuar”, është shprehur Rudari.

Kandidati i LDK-së për kryetar të kësaj komune ka thënë se dy kundërkandidatët e tij, Shpejtim Bulliqin nga LV-ja dhe Naim Fetahun nga PDK-ja, nuk i sheh konkurrentë në këtë garë. Rudari ka vlerësuar se atyre u mungon përvoja në qeverisje lokale. “Mendoj se ky do të jetë lehtësim për mua sepse unë kam qenë bashkëpunëtor i ngushtë me z. Veliu gjatë kësaj kohe qoftë si drejtor i Arsimit, qoftë për një vit e gjysmë si nënkryetar i komunës. Mendoj se do të jetë një lehtësim për mua ngaqë kam qenë i kyçur në të gjitha proceset dhe fazat e projekteve komunale. Meqenëse kam njohuri për të gjitha punët që janë kryer dhe ato që duhet të kryhen në Podujevë, kjo do të jetë një rrethanë lehtësuese për mua”,



ka thënë Rudari. Edhe kandidati i Lëvizjes Vetëvendosje për kryetar të Komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka shprehur optimizëm për fitore në zgjedhjet e 15 marsit. Ai ka deklaruar për gazetën “Epoka e re” se zgjedhjet e fundit kombëtare kanë treguar se kjo komunë nuk është më bastion i asnjë partie politike.

Bulliqi është shprehur i bindur se në këtë garë do ta marrë besimin për ta qeverisur Komunën e Podujevës. “Mendoj se koha e bastioneve ka kaluar në Kosovë. Tanimë asnjë komunë nuk mund të llogaritet se është bastion i këtij apo atij subjekti politik. Ju e dini se në zgjedhjet e fundit nacionale në komunën tonë dallimi në mes të LDK-së dhe LV-së ka qenë mbi 1 000 vota. Prandaj, në këtë aspekt mendoj se më nuk mund ta quajmë Podujevën si bastion të një partie, nëse diferenca mes këtyre dy subjekteve politike është mbi 1 000 vota. Sigurisht se gjatë fushatës do të angazhohemi fuqishëm që në radhë të parë ta marrim besimin e qytetarëve dhe këtë besim të qytetarëve pastaj ta shndërrojmë në punë dhe angazhime që janë në interes të qytetarëve të Podujevës”, ka thënë ai.

Bulliqi ka bërë me dije se gjatë fushatës zgjedhore i mbetet vetëm ta prezantojë programin para qytetarëve të kësaj komune. “Unë kam besim të plotë që besimi i qytetarëve të Podujevës



nuk do të mungojë për programin tonë dhe për mbështetjen e Lëvizjes Vetëvendosje dhe për mua si kandidat për kryetar të kësaj komune. Tashmë nuk kemi dilema në këtë aspekt. Na mbetet që gjatë kësaj kohe të afrohem sa më tepër te qytetari, t’i japim sqarimet konkrete se cili është vizioni ynë për qeverisjen lokale. Ndërsa përkrahja e qytetarëve nuk do të mungojë në këtë aspekt”, është shprehur Bulliqi. Ai ka treguar se në programin të tij përfshinë të gjitha fushat që janë me interes për Komunën e Podujevës. Kandidati i LV-së për kryetar të kësaj komune ka thënë se synon depolitizimin e shërbyesve publikë.

Ndërkaq kandidati i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) për kryetar të Komunës së Podujevës, Naim Fetahu, ka thënë se kësaj radhe si asnjëherë më parë po vërehet një disponim i mirë i qytetarëve të Podujevës që ta bëjnë ndryshimin e madh në këtë komunë. Ai ka thënë se Podujeva ka nevojë për fitoren e PDK-së. “Ne jemi të vendosur për t’i fituar këto zgjedhje dhe do t’ia dalim. Këto ditë kam marrë shumë mesazhe përkrahje nga qytetarët që më herët kanë votuar për LDK-në dhe LV-në. Dhe a dini se çfarë më thonë në takimet e përditshme, se këta vetëm i ndryshojnë partitë për interesa të tyre, por nuk mendojnë për qytetarët. Fitorja e PDK-së është ajo për të cilën ka nevojë Podujeva dhe qytetarët e saj dhe për këtë do të



angazhohemi që ta realizojmë”, ka thënë Fetahu.

Duke treguar arsyet se pse do të fitojë në zgjedhjet e 15 marsit, ai ka thënë se kjo komunë ka ngecur në të gjitha fushat. “Lajmi i vetëm i cili ka dalë në sipërfaqe nacionale nga kjo komunë në këto vite ka qenë vendosja e semaforëve. Asgjë tjetër. Zero. Podujeva sot është një nga komunat me më së paku zhvillim. Të rinjtë e Podujevës, të cilët janë shumica e popullsisë, është dashur që të anëtarësohen në LDK që të gjejnë një vend pune. Bujqit, të cilët kanë qenë krenaria e kësaj komune, sot janë lënë anash. Madje shumë fshatra nuk kanë as ujë të pijshëm e as rrugë të denja për të kaluar”, është shprehur Fetahu.

Kandidati i PDK-së për kryetar të Podujevës ka thënë se dy kundërkandidatët e tij janë të konsumuar dhe pa ide. “E gjitha që unë i kam dhënë Podujevës dhe Kosovës, kanë qenë vitet e mia më të mira në luftën për liri dhe rindërtimin e vendit në pozita të ndryshme ekzekutive që kam pasur në nivel qendror. Prandaj, po e përsëris, qytetarët e Podujevës i dinë këto gjëra dhe do t’i shfrytëzojnë këto zgjedhje për t’i larguar kapësit e qytetit nga pushteti”, është shprehur Fetahu.

Zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar të Komunës së Podujevës mbahen më 15 mars, pas dorëheqjes së Agim Veliut nga pozita e kryetarit, i cili është emëruar ministër i Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike.

Kuvendi i Kosovës ka mbajtur seancë të jashtëzakonshme për taksën ndaj Serbisë dhe Bosnjë Hercegovinës

DEBAT I ASHPËR NË MES TË POZITËS DH

Subjektet politike as të hënën në Kuvendin e Kosovës nuk kanë arritur një qëndrim të përbashkët për taksën ndaj produkteve serbe. Për disa orë pozita dhe opozita kanë polemizuar për këtë çështje duke prezantuar qëndrimet e tyre për dhe kundër heqjes së taksës. Partitë kanë kërkuar unitet për taksën dhe dialogun me Serbinë, por asnjëra prej tyre nuk ka treguar gatishmëri për një gjë të tillë. Në debatin e gjatë parlamentar, vetëm AAK-ja ka kërkuar mbajtjen e taksës, kurse LDK-ja, PDK-ja dhe Nisma kanë kërkuar që kjo çështje të bëhet siç po kërkon ShBA-ja. Ndërsa kryeministri Albin Kurti ka prezantuar planin për heqje të pjesshme të taksës



EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 2 MARS - Pozita dhe opozita kanë debatuar për shumë orë të hënën rreth taksës 100 për qind ndaj importeve nga Serbia dhe Bosnjë Hercegovina. Subjektet politike, ndonëse kanë kërkuar unitet për këtë çështje, ato vetëm kanë prezantuar qëndrimet e tyre dhe nuk kanë shprehur ndonjë gatishmëri për qëndrim të përbashkët. I vetmi subjekt politik që ka kërkuar mbajtjen e tarifës ka qenë AAK-ja, e cila ka thirrur këtë seancë të jashtëzakonshme.

Shefi i grupit parlamentar i kësaj partie, Daut Haradinaj, ka thënë se ekzistojnë 100 arsye për të mos e hequr taksën. "Deputetë të nderuar, ju ftoj që sot të gjithë të jemi unikë përballë Serbisë. Në këtë Kuvend mund ta dëshmojmë se sa jemi të vendosur. Pra, këtu sot mund ta vendosim fatin tonë se çka do të ndodhë nesër për një diskutim apo kompromis, siç po quhet, i dhimbshëm. E çka mund të jetë ai kompromis? A do të jetë 'Zajednica' (Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe) apo do të jetë copëtimi i Kosovës, kjo mbetet të shihet dhe këtë e kanë në dorë vetë

kryeministri dhe partnerët e tij", ka thënë Haradinaj.

Ai i ka bërë thirrje kryeministrit Kurti që të mos e heqë taksën ndaj prodhimeve të Serbisë, duke thënë se për këtë do ta ketë mbështetjen e Aleancës së Ardhmërisë së Kosovës.

Ndërsa dy partitë në pushtet, LV-ja dhe LDK-ja, e kanë kundërshtuar qëndrimin e AAK-së, duke thënë se taksa nuk është e mjaftueshme për të krijuar pozicion të favorshëm të Kosovës ndaj Serbisë. Shefi i grupit parlamentar i LV-së, Rexhep Selimi, ka thënë se reciprociteti do të jetë mjet më i fuqishëm në raport me Serbinë. "Duke marrë parasysh që subjektet politike opozitare nuk kanë paraqitur ndonjë qëndrim të përbashkët politik sa i përket kësaj çështje, ndonëse e kanë nënshkruar bashkërisht kërkesën për seancë, duke marrë parasysh, po ashtu, se përveç diskutit të ndryshëm me njëri-tjetrin, kanë edhe qëndrime politike kontroverze për taksën 100 për qind ndaj Serbisë dhe Bosnjës, si dhe për reciprocitetin me Serbinë, pashmangshëm shtrohet pyetja se çka po kërkon sot opozita, mbajtjen apo heqjen e taksës 100 për qind ndaj produkteve të Serbisë dhe Bosnjë e Hercegovinës", ka thënë Selimi.

Edhe Arben Gashi, shef i grupit parlamentar i LDK-së, ka thënë se të dy partnerët e koalicionit që nga fushata elektorale kanë deklaruar se taksën do ta zëvendësojnë me masën e reciprocitetit. "Me synim për mbylljen e procesit të dialogut dhe marrëveshjen përfundimtare me Serbinë, Lidhja Demokratike e Kosovës synon të bashkëpunojë dhe t'i bashkërendojë veprimet me aleatët tanë, në radhë të parë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, duke i njoftuar fillimisht me listën gjithëpërfshirëse të pengesave ekonomike dhe politike që Serbia po i ndërmerret ndaj Kosovës", ka thënë Gashi. Ai ka

shtuar se me tarifën e hequr, në rast se dialogu nuk rezulton t'i prodhohë rezultatet e pritura dhe politika e Serbisë nuk ndryshon, masat reciproke të identifikuar do të vendosen sipas një plani të bashkërenduar në mes të partnerëve të koalicionit, por edhe spektrit politik në Kosovë. Edhe shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Bedri Hamza, ka thënë se për taksën Kosova duhet të jetë në koordinim me ShBA-në. Sipas tij, ato që Kosova dëshiron t'i arrijnë si shtet, përmes taksës ndaj prodhimeve të Serbisë, kundër agresivitetit politik të Serbisë, tashmë mund të bëhen me efikasitet më të madh në

koordinim me partnerët strategjikë. "Kjo qeveri nuk ka plan as të përgjithshëm e as konkret dhe për më shumë, situatën aktuale e ka marrë nënshprehje dhe nuk i nxitohet. Ne dëshirojmë që këtë çështje ta shtrojmë përtej taksës. A janë të përgatitura institucionet, a kanë vizion dhe plan të qartë për dialogun, a kanë gatishmëri, pasi që mendoj se çështja është edhe më e rëndësishme dhe shkon përtej taksës. A janë të përgatitura dhe të gatshme për marrëveshjen finale, e cila do të hapte dhe përshpejtonte rrugën e Kosovës drejt integritetit evropian, anëtarësimit në NATO dhe sigurimit të ulësës në

IKShPK-ja: Në Kosovë nuk ka koronavirus

PRISHTINË, 2 MARS (ER) - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se nga data 08.02 deri më 02.03.2020 në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 36 mostra të dyshimta në virusin SARS-CoV-2 dhe të gjitha kanë rezultuar negative. "Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) gjatë ditës së sotme, më 2 mars 2020, ka marrë informatë nga Klinika Infektive e QKUK-së për

tri raste të dyshimta në COVID-19. Pacientët u kontrolluan nga ekipi i infektologëve në Klinikën Infektive në QKUK dhe iu morën mostrat për testim laboratorik në virusin SARS-CoV-2. Me datë 02.03.2020, në laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK, janë testuar tre pacientë në virusin SARS-CoV-2 dhe kanë rezultuar negativ, domethënë të tre pacientët nuk janë të infektuar me virusin SARS-CoV-2. Njëkohësisht pacientët janë testuar në Influenza A dhe B,

dhe njëri prej tyre ka rezultuar pozitiv në Influenza B", është thënë në njoftimin e IKShPK-së. IKShPK-ja ka njoftuar se nga data 1 shkurt deri më 2 mars në aeroportin ndërkombëtar "Adem Jashari" si dhe në pikat tokësore kufitare janë depistuar gjithsej 1 643 udhëtarë. "Në Aeroportin 'Adem Jashari' 327 udhëtarë, Vërmicë 523, Merdar 644, Hani i Elezit 28, Dheu i Bardhë 37, Jarinje 65, Bërnjak 5, Kullë 7 dhe Qafë Morinë 7 udhëtarë", është thënë në njoftimin e IKShPK-së.



E OPOZITËS PËR TAKSËN NDAJ SERBISË



Organizatën e Kombeve të Bashkuara”, ka thënë Hamza.

Kurti nuk heq dorë nga plani për taksën

Pasi ka dëgjuar qëndrimet e subjekteve politike për këtë çështje, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka paraqitur planin për heqjen e taksës, të cilën e kishte prezantuar ditë më parë. Ai ka njoftuar se më 15 mars do të hiqet taksa për lëndën e parë që importohet nga Serbia dhe Bosnjë Hercegovina. Ai ka thënë se nëse Serbia e ndal fushatën për çnjohje dhe zotohet për heqjen e barrierave jotarifore, nga 1 prilli taksa do të hiqet për një periudhë prej 90

ditësh. Nëse Serbia nuk u përmbahet këtyre zotimeve, sipas Kurtit, nga 15 qershori do të rivendoset taksa 100 për qind dhe do të zbatohet parimi i reciprocitetit. “Çdo heqje e një barriere nënkupton një njohje më tepër e sovranitetit territorial të Kosovës. Ne duhet ta detyrojmë Serbinë që t’i njohë një nga një të gjitha dokumentet e Kosovës që e dëshmojnë sovranitetin e shtetit tonë”, ka deklaruar Kurti.

Për këto qëndrime kryeministri është kritikuar nga opozita. Lideri i PDK-së, Kadri Veseli, ka deklaruar se shenjtërinë e marrëdhënieve të Kosovës me partnerët strategjikë, të ndërtuar me dekada, Albin Kurti është i gatshëm ta rrënojë brenda ditësh. “Madje, duke instaluar edhe frymën anti-amerikane te qytetarët, ai po ia sjell Kosovës rrezikun më të madh të mundshëm, që as Serbia nuk ka mundur t’ia bëjë. E ardhmja e shtetit të Kosovës është e pasigurt dhe e rrezikuar me këtë koalicion dhe me Albin Kurtin kryeministër”, ka thënë Veseli.

Ai ka deklaruar se nuk ka ndryshuar qëndrim për taksën, duke shtuar se, ashtu siç kishte propozuar ai para një viti, kjo taksë duhet të suspendohet. “Në janar të vitit 2019 me një draft-dokument unë kam propozuar pezullimin e taksës për 120 ditë, për t’i dhënë mundësi arritjes së marrëveshjes përfundimtare gjatë kësaj periudhe kohore. Nëse nuk do të arrihej marrëveshja, do të rikthehej taksa dhe do të vendosej reciprociteti i plotë. Arsyeja e vendosjes së taksës ishte legjitime, që të mbrohem nga agresiviteti i Serbisë kundër Kosovës. Por, edhe atëherë, sikurse edhe sot, taksa kërkohet të hiqet me insistim nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës”, është shprehur ai.

Kurse lideri i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka kritikuar kryeministrin Kurti

se ka humbur mundësinë e negociimit me Serbinë. “Ju keni humbur mundësinë e negociimit. Mos i ikni dialogut dhe mos i ikni përgjegjësisë. Lëri këto aktrime, se nuk të ndihmojnë. Krejt bota po merret me dialogun, e ti vjen këtu e thua Hashimi nuk bën të merret me dialogun. E thua unë jam. Çka po pret, merre detyrën burrë. Pse po bën hajgare veç lëndën e parë, pas 15 ditësh ke thënë e heq krejt”, ka thënë Limaj.

Ai ka thënë se 70 për qind të fjalimit të kryeministrin Kurti ishte për LDK-në. “70 për qind të fjalimit tënd ka qenë për LDK-

në, jo për neve. Po dëshiron t’i dërgosh përsëri selame kryetarit të LDK-së. E shikon Kadri, sepse e ke sëmundje Kadri, por, në fakt, e ke pasur fjalimin për LDK-në. Ne i lexojmë këto gjëra”, ka thënë Limaj.

Presidenti i Aleancës Kosova e Re (AKR), Behgjet Pacolli, ka kërkuar që të hiqet taksa ashtu siç janë duke kërkuar Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA). “Tani është koha në pikëpamje të AKR-së që Kosova të marrë një vendim për heqjen e taksave sipas propozimit amerikan në kuadër të angazhimit të fuqishëm të Kosovës drejt aleancës strategjike dhe të

pazëvendësueshme me Shtetet e Bashkuara”, ka shkruar Pacolli në llogarinë e vet në “Facebook”. Taksa 100 për qind u vendos në nëntor të vitit 2018 nga Qeveria e Kosovës, që atëbotë udhëhiqej nga Ramush Haradinaj. Kjo taksë është vlerësuar si pengesë për vazhdimin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, pasi kjo e fundit ka refuzuar që të kthehet në tavolinën e bisedimeve pa u hequr taksa. ShBA-ja, por edhe Bashkimi Evropian në vazhdimësi kanë kërkuar nga autoritetet në Prishtinë që të heqin taksën për t’i hapur rrugë rinisjes së dialogut.



AAK-ja ia dërgoi një arkivol kryeministrin Kurtit para qeverisë

PRISHTINË, 2 MARS (ER) - Aleanca e të Rinjve të Kosovës, që i përket partisë opozitare Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), ka vendosur të hënën një arkivol me disa mbishkrime pranë ndërtesës së qeverisë, teksa deputetët e Kuvendit po debatojnë për taksën 100 për qind.

Kjo parti po kundërshton planin e kryeministrin Albin Kurti për heqjen e taksës ndaj produkteve nga Serbia dhe Bosnjë e

Hercegovina.

Pas këtij veprimi anëtarët e AAK-së janë arrestuar nga policia. Për arrestimin e tyre ka reaguar lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj. “Dënoj ashpër aktin e arrestimit të aktivistëve të Aleancës së të Rinjve të AAK-së, Naim Ramizi, Musa Lekaj dhe Edonis Kamberi, të cilët ishin duke realizuar një aksion simbolik kundër heqjes së taksës, para objektit të qeverisë. Trajtimi policor i qytetarëve të ndershëm, vetëm pse ia kujtojnë



kryeministrin Kurti shkeljen flagrante të parimeve të dikurshme, është kundër frymës së Kushtetutës së Kosovës dhe ligjeve në fuqi. I bëjmë thirrje

pushtetit dhe institucioneve të rendit, që t’i lirojnë menjëherë aktivistët e arrestuar dhe të mos ua shkelë të drejtën e garantuar të kundërshtimit paqësor e politik qytetarëve të Republikës së Kosovës”, ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në “Facebook”.

Për arrestimin dhe lirim të aktivistëve të AAK-së ka dhënë sqarim edhe Policia e Kosovës. “Rreth orës 11:30 nga njësitë policore të stacionit ‘Qendra’ janë

shoqëruar katër persona, për një aktivitet që është mbajtur sot në sheshin ‘Skënderbeu’ në Prishtinë. Intervistimi i organizatorëve të aktivitetit dhe largimi i arkivolit është bërë me urdhrë të prokurorit të Shtetit. Personat janë intervistuar në cilësinë e dëshmitarëve dhe më pas janë liruar, ndërkohë që arkivoli, pas ekzaminimit nga ana e njësive kompetente, është larguar nga vendi i ngjarjes”, ka njoftuar Policia e Kosovës.

Komandanti i FSK-së vizitoi Maqedoninë e Veriut

SHKUP, 2 MARS (ER) - Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), gjeneralletenant Rrahman Rama, ka qëndruar për vizitë zyrtare në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Komandanti i FSK-së në Komandën e Ushtrisë të Republikës së Maqedonisë së Veriut u prit me ceremoni ushtarake. Sipas një njoftimi të Ministrisë së Mbrojtjes, gjatë vizitës komandanti i FSK-së, gjeneralletenant Rrahman Rama, fillimisht u prit në takim nga ministrja e Mbrojtjes e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Radmila Shekerinska, e cila shoqërohej nga drejtori i Shtabit të Ushtrisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, gjeneralmajor Zoran Milevski.

Gjatë takimit të përbashkët të gjeneral Ramës dhe ministres Shekirinska u bisedua për marrëdhëniet e mira dhe bashkëpunimin e suksesshëm në mes dy ministrive.

Komandanti i FSK-së në Komandën e Ushtrisë të Republikës së Maqedonisë së Veriut u prit nga shefi i Shtabit të Ushtrisë së Republikës të Maqedonisë së Veriut, gjeneralletenant Vasko Gjurqinovski. Pas pritjes protokollare të dy gjeneralët zhvilluan një takim pune kokë me kokë. Po ashtu, komandanti i FSK-së, gjeneral Rama, u prit në takim edhe nga presidenti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Stevo Pendarovski, i cili shoqërohej nga shefi i Shtabit të Ushtrisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, gjeneralletenant Vasko Gjurqinovski, kurse komandanti i FSK-së, gjeneral Rama, shoqërohej nga zëvendësambasadori i Republikës së Kosovës në Maqedoni, Flurim Gashi, drejtori i ZMP-së, Ibrahim Shala, koloneli Hasan Hoxha, shef i Departamentit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integritet Euroatlantike në



Ministrinë e Mbrojtjes dhe major Jaser Mula, asistent ushtarak i komandantit.

Komandanti i FSK-së, gjeneral Rama, në fund vizitoi edhe Akademinë Ushtarake "Gjeneral Mihajlo Apostolski", ku u takua me kadetë të FSK-së, të

komuniteteve pakicë që studiojnë pa barriera gjuhësore në këtë akademi.

Nga zëvendëshefi i Shtabit të Ushtrisë së Maqedonisë së Veriut, gjeneralmajori Azin Nuredini u njoftua për kadetët e FSK-së, për nivelin e

angazhimeve të tyre, si dhe për sukseset e treguara. "Vizita e komandantit të FSK-së dëshmoi edhe një herë bashkëpunimin e mirë të deritashëm në mes të dy ushtrive", është thënë në njoftimin e Ministrisë së Mbrojtjes.

'Let's Do It Kosova' bën thirrje për mbrojtje të mjedisit

EPOKA
ERE

Q. RAMA

PRISHTINË, 2 MARS - Organizata "Let's Do It Kosova" me shqetësim i ka përcjellë zhvillimet e fundit në fushën e mjedisit, me theks të veçantë në rrethinën e Gjilanit, prej nga u raportua për djegie të gomave e mbeturinave dhe u publikuan shembuj të ndotjes së lumenjve. Gjatë ditës së diel u raportua për djegien e gomave e mbeturinave në Gjilan dhe nëpër medie sociale qarkulloi një video në të cilën dëshmohej ndotja e lumit të qytetit në fshatin Pasjak. Po ashtu, banorët e fshatit Kmetovc



u ankuan që një gropë, nga deponia për mbeturina interne po shfrytëzohet edhe për mbeturina të tjera.

Dëshmi për ndotje të ambientit u pasqyruan në një video të publikuar në rrjete sociale, në të cilën punëtorët e një restoranti në Brezovicë shihen duke hedhur mbeturina në mal.

"Let's Do It Kosova" bën thirrje për mbrojtje të mjedisit tek institucionet gjegjëse dhe qytetarët e vendit.

Duke qenë se ngjarjet e fundit janë zhvilluar kryesisht gjatë fundjavës, organizata u bën thirrje Policisë së Kosovës dhe Inspektorëve për angazhim shtesë në këto ditë.

"Let's Do It Kosova" po ashtu përsërit urgjencën për shqyrtimin e mundësisë për formimin e

Policisë Mjedisore, kërkesë kjo që është shtruar nga organizata tash e disa vjet.

"Let's Do It Kosova" është organizatë që merret me ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit në Kosovë, organizimin e qytetarëve për adresimin e problemeve dhe pjesëmarrjen e tyre në aktivitete të ndryshme, përfshirë aksione të pastrimit, fushata vetëdijësuese dhe aktivitete të tjera vullnetare. Organizata, e cila është pjesë e lëvizjes globale "Let's Do it World", e pranishme në 157 shtete anembanë botës, po ashtu punon edhe në fushata avokuese për të ndikuar te vendimmarrësit për zgjidhje të çështjeve mjedisore.

Përfaqësuesit e SBASHK-ut, FSSHK-së e SPK-së kërkojnë takim urgjent me Kurtin

PRISHTINË, 2 MARS (ER) - Përfaqësuesit e SBASHK-ut, të FSSHK-së, të SPK-së, të Sindikatës së Zjarrfikësve dhe të Doganave kanë mbajtur një takim të përbashkët duke debatuar për situatën në këta sektorë pas lajmit të shpërndarë se mund të mos jenë paraparë mjete në Ligjin e buxhetit për implementimin e Ligjit të pagave.

Ata kanë deklaruar se situata në sektorët që përfaqësojnë është

acaruar dhe se kanë nisur të shtohen kërkesat e anëtarësisë që të bëhen përgatitje për të nisur edhe me veprime sindikale nëse Ministria e Financave dhe kryeministri nuk ofrojnë dëshmi se janë bërë planifikime buxhetore për ligjin e pagave. "Duke u gjendur në këtë situatë përfaqësuesit e FSSHK-së, SPK-së, Sindikatës së Zjarrfikësve dhe Doganave kanë vendosur bashkërisht që t'i drejtohen kryeministrit Kurti

për një takim urgjent për të debatuar për këtë çështje. Në takimin me kryeministrin Kurti përfaqësuesit e këtyre pesë sindikatave do të kërkojnë nga ai që ta shpalojë planin e qeverisë për rritjen e mirëqenies së punëtorëve në Republikën e Kosovës nëse Ligji për paga zvarritet edhe më tutje", është thënë në njoftimin e SBASHK-ut, FSSHK-së, SPK-së, Sindikatës së Zjarrfikësve dhe Doganave.



Kurti u shkruan letër presidentit Trump dhe sekretarit Pompeo për taksën dhe dialogun

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 2 MARS - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, u ka dërguar letër presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump, si dhe Sekretarit të Shtetit, Mike Pompeo, në lidhje me programin qeverisës. Kurti ka falënderuar Trumpin për përkrahjen e vazhdueshme për Republikën e Kosovës si dhe për angazhimin e tij drejt krijimit të mundësive ekonomike, sigurisë dhe paqes së qëndrueshme në Ballkan. "Po jua drejtoj këtë letër që t'ju informoj për programin qeverisës dhe për Qeverinë e re të Republikës së Kosovës. Me këtë rast, dua t'ju falënderoj për përkrahjen tuaj të vazhdueshme për Republikën e Kosovës si dhe për angazhimin tuaj drejt krijimit të mundësive ekonomike, sigurisë dhe paqes së qëndrueshme në Ballkan. Ne e vlerësojmë jashtëzakonisht shumë interesin personal që keni treguar për të ardhmen e vendit dhe rajonit tonë. Programi qeverisës i Qeverisë së re të Kosovës është i fokusuar dhe përqendruar në dy shtylla kryesore. E para konsiston në zotimin tonë për të luftuar në mënyrë të pakompromis korrupsionin dhe krimin e organizuar. Shtylla e dytë, si prioritet kryesor, ka rritjen

ekonomike, zgjerimin e investimeve dhe krijimin e vendeve të punës. Këto dy procese janë reciprokisht të ndërlidhura, ndaj dhe ne e mirëpresim mbështetjen e vazhdueshme të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara në përpjekjet tona për ta zbatuar qeverisjen e mirë, sundimin e ligjit dhe rritjen e mundësive ekonomike për popullin e Kosovës", i ka shkruar në këtë letër Kurti presidentit Trump. Në letër kryeministri Kurti flet edhe për dialogun Kosovë - Serbi. "Qeveria ime dhe unë jemi të përkushtuar për zgjidhjen e çështjeve të mbetura ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë. Ne mbetemi të bindur se kjo duhet bërë përbrenda procesit të dialogut, i cili do të kulmonte me njohjen e ndërsjellë të dy shteteve. Ne besojmë se kjo është rrugë e rëndësishme për integrimin e Kosovës në bashkësinë ndërkombëtare dhe për arritjen e një marrëveshje historike që do të krijonte paqe të qëndrueshme, stabilitet dhe siguri në Ballkan", ka shkruar Kurti. Ai ka bërë të qartë se duke filluar nga 15 marsi Kosova do ta nisë heqjen e tarifave për mallrat nga Serbia dhe Bosnjë Hercegovina, të cilat janë vendosur nga qeveria e kaluar. "Fillimisht, do të hiqen tarifat për lëndët e para. Këtë e bëjmë si shprehje e gjetit të mirë



diplomatik dhe si shenjë për përkushtimin tonë për të punuar afër me Shtetet e Bashkuara në dialogun me Serbinë. Ne shpresojmë se veprimet tona do të kthehen me reciprocitet nga Beogradi, nga i cili presim t'i largojë të gjitha barrierat jotarifore për tregtinë me Kosovën, si dhe ta ndalojë fushatën për çnjohjet e Kosovës. Ne, po ashtu, ftojme Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimin Evropian për krijimin e mekanizmave monitorues dhe sanksionues, për të siguruar që të dyja palët t'u përmbahen zotimeve të bëra gjatë

marrëveshjeve të tanishme si dhe atyre në të ardhmen", ka shkruar Kurti, duke shtuar se Kosova është e vetëdijshme se gjatë dy vjetëve të fundit ka pasur mungesë të theksuar të koordinimit ndërmjet përfaqësuesve të Kosovës për rolin, interesin dhe qëllimet në dialogun me Serbinë, si dhe për mungesën e qartësisë se kush flet në emër të Kosovës në skenën ndërkombëtare dhe në tavolinën negociuese. "Kjo do të përfundojë me qeverinë që drejtoj unë. Qeveria dhe unë si kryeministër kemi mandatin kushtetues, vullnetin politik dhe detyrën ligjore, si dhe

përgjegjësinë e plotë dhe ekskluzive për të marrë përsipër udhëheqjen e këtij procesi dhe përfaqësimin e Kosovës në nivelin më të lartë diplomatik. Presim me padurim ta fillojmë punën me ju, diplomatët dhe emisarët tuaj, si dhe partnerët tanë në Bashkimin Evropian, për ta çuar përpara këtë proces. Qeveria ime i sheh marrëdhëniet e Kosovës me Shtetet e Bashkuara si marrëdhënie me rëndësinë më të lartë strategjike për vendin tonë, si aleancë që është e bazuar në vlera dhe interesa thellësisht të përbashkëta. Administrata juaj tashmë ka pasur ndikim të madh pozitiv në Ballkanin Perëndimor, duke sjellë energji të reja dhe zbatueshmëri në zgjidhjen e problemeve, gjë që ne e mirëpresim jashtëzakonisht shumë. Mezi presim ta thellojmë partneritetin dhe të punojmë së bashku me Shtetet e Bashkuara për shtimin e mundësive ekonomike, forcimin e sundimit të ligjit, rritjen e sigurisë rajonale, shtyrjen përpara të dialogut Kosovë-Serbi si dhe për çështje të tjera", ka shkruar Kurti në letrën drejtuar presidentit Trump. Kryeministri Kurti edhe sekretarin e Shtetit, Mike Pompeo, e ka njoftuar për programin qeverisës dhe procesin e dialogut me Serbinë.

Fillon procesi i deklarimit të pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë

Drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit, Shaip Havolli, ka shprehur zotimin se gjatë procesit të deklarimit të pasurisë Agjencia Kundër Korrupsionit do të jetë në shërbim të të gjitha subjekteve deklaruese për të ofruar të gjitha informatat e nevojshme për zyrtarët publikë në mënyrë që procesi i deklarimit të pasurisë të përfundojë me sukses, gjithnjë duke respektuar obligimet e përcaktuara me ligj

**EPOKA E RE**

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 2 MARS - Në pajtim me Ligjin për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publikë dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave, më 1 mars 2020 ka filluar procesi i deklarimit të rregullt vjetor të pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë, ku të

gjithë zyrtarët e lartë publikë janë të obliguar ta bëjnë deklarimin e pasurisë së tyre në Agjencinë Kundër Korrupsionit. Me këtë rast, Agjencia Kundër Korrupsionit ka dërguar njoftimin te të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës (zyrtarët kontaktues për deklarimin e pasurisë) që ta bëjnë deklarimin e pasurisë sipas afateve kohore të përcaktuara me Ligjin për

Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publikë dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave nga data 1 deri më 31 mars 2020. Drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit, Shaip Havolli, ka shprehur zotimin se gjatë procesit të deklarimit të pasurisë Agjencia Kundër

Korrupsionit do të jetë në shërbim të të gjitha subjekteve deklaruese për të ofruar të gjitha informatat e nevojshme për zyrtarët publikë në mënyrë që procesi i deklarimit të pasurisë të përfundojë me sukses, gjithnjë duke respektuar obligimet e përcaktuara me ligj. Deklarimit të rregullt vjetor i

pasurisë janë të obliguar t'u nënshtrohen të gjithë zyrtarët e lartë publikë, me përjashtim të atyre që kanë deklaruar pasurinë me rastin e marrjes së detyrës pas datës 1 janar të këtij viti. Në njoftimin dërguar në institucionet publike, Agjencia Kundër Korrupsionit ka rikujtuar se mosdeklarimi i rregullt i pasurisë nga zyrtarët publikë dhe mosrespektimi i Ligjit nr. 04/L-050, si dhe Ligjit nr. 04/L-228 për deklarimin e pasurisë nga ana e zyrtarëve të lartë publikë, Agjencia Kundër Korrupsionit do të paraqesë kallëzim penal në pajtim me nenin 437 të Kodit Penal. Për informata më të hollësishme rreth subjekteve deklaruese dhe listës së zyrtarëve të cilët janë të obliguar ta bëjnë deklarimin e pasurisë vizitohen uebfaqet zyrtare të AKK-së.

Bahtiri: "Trepça" është keqpërdorur e keqmenaxhuar nga menaxhmentet

MITROVICË, 2 MARS (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka pritur të hënën në një takim zyrtarët nga Zyra e Prokurimit në "Trepça" Sh.A, Bajram Jashari, Jusuf Jusufi dhe Naser Bajrami, të cilët janë larguar përkohësisht nga puna më 20 dhjetor 2019 nga kryeshefi ekzekutiv i kësaj ndërmarrje, Basri Ibrahim.

Në këtë takim zyrtarët në fjalë kanë njoftuar kryetarin Bahtiri për shqetësimet e tyre në lidhje me vendimin mbi largimin e përkohshëm nga puna të katër zyrtarëve të Zyrës së Prokurimit në ndërmarrjen "Trepça" Sh. A. Zyrtari i Prokurimit në "Trepça" Sh.A., Bajram Jashari, theksoi se vendimi për largim të përkohshëm nga puna ka ardhur për shkak të një tenderi për shujtat e punëtorëve të "Trepçës", me ç'rast ka fituar

kompania "Beni Dona Plast" Sh.P.K., të cilin e ka përzgjedhur komisioni i përbërë prej pesë anëtarëve.

"Kryeshefi ekzekutiv Basri Ibrahim i bashku me auditorin Kujtim Saraqi kanë bërë presion te ne që ky tender t'i jepet operatorit NTP 'Verona', e jo 'Beni Dona Plast' Sh.P.K. dhe ne kemi vepruar në bazë të ligjit dhe nuk kemi lejuar të shfuqizohet vendimi i komisionit vlerësues. Me këtë rast, pa ndonjë paralajmërim dhe me një vendim absurd, duke u bazuar te një gabim teknik i cili është përmirësuar në kontratën tjetër, si dhe pa vendim të komisionit disiplinor, kryeshefi ekzekutiv i 'Trepçës' ka marrë vendim të na largojë përkohësisht nga puna" ka thënë, ndër të tjera, zyrtari i Prokurimit në "Trepçë", Jashari.



Po i njëjti potencon se katër zyrtarët e larguar përkohësisht nga puna iu kanë drejtuar komisionit disiplinor me ankesë të bazuar, gjë që ata kanë vendosur për kthimin e tyre në punë, ku kryeshefi ekzekutiv, Ibrahim, nuk e ka respektuar këtë vendim, duke i

larguar ata nga zyra. Ndërsa kryetari Bahtiri, pasi dëgjoi shqetësimet e zyrtarëve, tha se "Trepça" si kombinat i fuqishëm ekonomik është keqpërdorur e keqmenaxhuar nga menaxhmentet e tij dhe se vendimet e tyre ishin më shumë politike sesa profesionale e

zhvillimore për këtë ndërmarrje.

Gjithashtu, kryetari Bahtiri kërkon nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik të ketë ndikim dhe ta shtrijë autoritetin që ka, në mënyrë që të ndërmerren masa në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Agjencia Kadastrale dhe Posta nisin bashkëpunimin për përdorimin e adresave zyrtare



EPOKA
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 2 MARS - Agjencia Kadastrale e Kosovës është autoriteti qendror për mirëmbajtjen e bazës së të dhënave kadastrale për mirëmbajtjen e regjistrave pronësorë, për hartografi dhe GIS, për sistemin e unifikuar të adresave, për infrastrukturën kombëtare të të dhënave hapësinore dhe për administrimin e Infrastrukturës së Teknologjisë së Informacioneve. Si e tillë, Agjencia Kadastrale e Kosovës është në përpjekje të

vazhdueshme të zgjerimit të rrjetit të bashkëpunëtorëve të vet nga institucionet publike, sidomos të atyre që në baza të rregullta përdorin produktet dhe shërbimet e saj. Njëherësh, duke marrë parasysh se Agjencia Kadastrale e Kosovës së fundmi ka ndërmarrë disa reforma ligjore të cilat avancojnë regjistrimin e pronës dhe sistemin e adresave, ajo ka filluar një fushatë intensive takimesh me palë të interesit të cilat janë të sulmuara nga këto ndryshime legislative.

Për këtë arsye, të hënën në ambientet e Agjencisë Kadastrale të Kosovës është mbajtur një takim pune mes kryeshefit të

Agjencisë Kadastrale të Kosovës, Avni Ahmeti, i cili ishte i shoqëruar edhe nga drejtoresha e Drejtorisë për Teknologji të Informacionit në AKK, Afërdita Thaçi dhe udhëheqësin e Njësisë për Sistemin e Adresave në AKK, Amir Sogojeva, me përfaqësues të Postës së Kosovës, kryeshefin ekzekutiv të Postës së Kosovës, Shefqet Avdija, drejtorin e Operativës Burim Geci, menaxherin e TI-së dhe SI-së, Ragip Zogiani dhe zyrtarin për Marrëdhënie me Publikun, Arsim Mehmeti.

Në takim, pos shkëmbimit të informacioneve të përgjithshme të institucioneve respektive dhe

identifikimit të fushave ku bashkëpunimi do të mund të rritej, është nënshkruar edhe një marrëveshje bashkëpunimi me theks të veçantë rreth shfrytëzimit të adresave zyrtare të Republikës së Kosovës nga Posta e Kosovës.

Kjo marrëveshje, pos që ka për qëllim bashkëpunimin e dy institucioneve rreth shfrytëzimit dhe shpërndarjes së të dhënave të adresave zyrtare, rregullon edhe përgjegjësitë e institucioneve në fjalë karshi përdorimit të adresave si dhe njëh dhe fuqizon rolin e Postës së Kosovës rreth informimit të të dhënave të adresave zyrtare te

qytetarët, bizneset, institucionet dhe organizatat e ndryshme.

Posta e Kosovës ka shprehur gatishmëri që ta bëjë shpërndarjen individuale/personale të dërgesave/informacionit te të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës me qëllim të informimit rreth adresave në vendbanimet ku jetojnë.

Palët u pajtuan që AKK-ja ta iniciojë formimin e grupit punues të përbashkët me zyrtarë të Postës së Kosovës, krejt me qëllim të ngritjes së kualitetit të shërbimeve ofruar qytetarëve dhe institucioneve të Republikës së Kosovës.

Veliu e Tolaj flasin për modalitetet e bashkëpunimit mes MPBAP-së dhe AKP-së



PRISHTINË, 2 MARS (ER) - Ministri i Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike, Agim Veliu, ka pritur të

hënën në takim drejtorin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Valon Tolaj. Në këtë takim u diskutua për projektet e përbashkëta të

dy institucioneve dhe modalitetet e bashkëpunimit mes MPBAP-së dhe AKP-së. Me këtë rast ministri Veliu

ka shprehur gatishmërinë e tij për mbështetje të AKP-së me qëllim të administrimit sa më të mirë të ndërmarrjeve shoqërore.

Koronavirusi mund ta çorientojë tregun

PRISHTINË, 2 MARS - Ekonomia e Kosovës nuk mund të mbetet immune ndaj ndikimit që ka koronavirusi i ri në rrjedhat e ekonomisë dhe tregut evropian e botëror, thonë përfaqësues të komunitetit të bizneseve dhe njohës të çështjeve ekonomike. Koronavirusi i ri, i emëruar COVID-19, për herë të parë është raportuar të jetë paraqitur në Kinë, në dhjetor të vitit 2019. Kurse Italia është kthyer në shtetin evropian të prekur më së shumti nga virusi. Italia është një ndër partneret kryesore tregtare me Kosovën. Mbi 200 milionë euro llogariten shkëmbimet e mallrave. Në një situatë të tillë, ekspertët thonë se është e logjikshme që tani bizneset të jenë në kërkim edhe të tregjeve të tjera, duke i zëvendësuar tregjet e vendeve të prekura nga ky virus.

Berat Rukiqi, kryetar në Odën Ekonomike të Kosovës, në një bisedë për "Radion Evropa e Lirë" thotë se nuk ka vend për panik për konsumatorët në lidhje me produktet që vijnë nga Italia apo vendet e tjera të prekura. Në rastin e Kosovës, ai thotë se vetëm mund të ndryshohet orientimi i importit të mallrave nga këto shtete.

"Deri tash kemi një tendencë për riorientim të importeve. Pra, një hezitim të importohet nga Kina dhe të shikohen tregjet e tjera të importeve për produkte të caktuara që janë importuar deri më tani prej vendeve të prekura nga koronavirusi. Kështu që nuk ka diçka shqetësuese", ka thënë Rukiqi.

Në vitin 2019 Italia ka eksportuar mallra në Kosovë në vlerë mbi 220 milionë euro, kurse ka eksportuar rreth 20

milionë euro dhe renditet në top-pesëshen e shteteve nga të cilat Kosova importon më së shumti mallra.

Ndërkaq, në vitin 2018 në Kosovë janë importuar mallra nga Kina në vlerë prej rreth 312 milionë eurosh, kurse mallra nga Kosovë në Kinë janë eksportuar mbi 1.4 milion euro. Ndërkaq, rreth 6 300 ka qenë numri i turistëve nga shteti i Italisë në Kosovë në vitin 2018. Në Odën Ekonomike të Kosovës thonë se ndikimi mund të jetë më shumë psikik dhe do t'i prekë lëvizjet e njerëzve, por nuk do të duhej t'i prekte edhe shkëmbimet tregtare. Ndërkohë, ekspertët për çështje ekonomike konsiderojnë se përhapja e sëmundjeve dhe epidemive të ndryshme

shkakton shqetësime të përgjithshme shoqërore dhe lëkundje sociale të cilat reflektohen edhe në ecuritë ekonomike të shteteve. Eksperti Naim Gashi thotë se duke marrë parasysh se disa shtete në të cilat është shfaqur koronavirusi janë partnerë ekonomikë të Kosovës, qoftë në aspektin e investimeve apo në fushën e tregtisë atëherë, sipas tij, mund të ketë efekte negative edhe në ecurinë e bashkëpunimit ekonomik dhe tregtar ndërmjet këtyre shteteve. "Përhapja e sëmundjeve dhe epidemive të ndryshme është një nga faktorët kryesorë që njerëzit frikësohen të konsumojnë mallra dhe shërbime. Në momentin që ulet konsumi i mallrave dhe shërbimeve atëherë kemi rënie të Bruto Produktit Vendor për faktin se njerëzit janë të frikësuar nga epidemitë dhe nuk shpenzojnë



ose nuk investojnë nga frika e përhapjes së sëmundjeve dhe rreziqet potenciale të bizneseve të tyre", ka thënë Gashi për "Radion Evropa e Lirë".

Kosova nuk mund të jetë immune ndaj lëkundjeve apo ndryshimeve në tregjet botërore, thotë Gashi, duke vlerësuar se zhvillime të tilla ndikojnë negativisht në ecuritë ekonomike globale. "Dihet se ne kemi rreth 4 miliardë euro të mallrave të cilat vijnë në tregun e Kosovës dhe për rrjedhojë një pjesë e këtyre mallrave vijnë

nga vendet e prekura nga koronavirusi. Unë mendoj se institucionet kompetente shtetërore në Kosovë duhet të jenë shumë vigjilente që ta këshillojnë popullatën se shqetësimet e mëdha dhe paniku në popullatë, përveç problemeve të përgjithshme të funksionimit të shtetit, ndikojnë negativisht edhe në ecuritë ekonomike dhe për rrjedhojë edhe bizneset do të kenë më pak shitje, më pak fitime dhe më pak investime", ka deklaruar Gashi.

Kosova është shteti që është i varur nga importi i produkteve të huaja, qoftë nga rajoni apo nga vendet e Bashkimit Evropian, sepse industria e prodhimit vendor ende mbetet pak e zhvilluar. Koronavirusi ka prekur rreth 86 000 mijë njerëz në botë. Në Kinë shifrat e fundit flasin për mbi 2 800 raste me fatalitet, ndërkaq në pjesët e tjera të botës janë shënuar mbi 100 raste të vdekjeve nga ky virus. Në Kosovë deri më tani nuk është shënuar asnjë rast me këtë virus.

Zvicra, vendi më i shtrenjtë në botë, Kosova, e 124-ta

PRISHTINË, 2 MARS - Zvicra është zyrtarisht vendi më i shtrenjtë në botë për të jetuar. Kështu është thënë në një raport të revistës "CEOWORLD". Pas saj renditet Norvegjia, e pasuar nga Islanda, Japonia, Danimarka, Bahamas, Luksemburgu, Izraeli, Singapori dhe Koreja e Jugut. Revista "CEOWORLD"

vlerësimin e ka bazuar në disa shpenzime për jetesën, përfshirë: strehimin, veshmbathjen, ushqimet, internetin, transportin dhe ngrënien jashtë. Këto të dhëna pastaj futen në një indeks, duke përdorur Nju Jorkun, qytetin më të shtrenjtë në botë, si pikë reference. Nju Jorku ka 100 pikë në indeks. Rrjedhimisht,

një vend me më shumë se 100 pikë është më i kushtueshëm se Nju Jorku, ndërsa me më pak sinjalizon se është më i lirë. Në listën prej 132 vendesh, Kosova renditet e 124-ta. Sipas kësaj liste, vendet më të përballueshme për jetesë janë: Pakistani, Afganistani, India, Siria, Uzbekistani, Kirgizia dhe Tunizia.



Në 21-vjetorin e rënies përkujtohet dëshmori Hetem Hasaj

KAÇANIK, 2 MARS (ER) - Krerët komunalë të Komunës së Kaçanikut, organizatat e dala nga lufta, familjarë të dëshmorit dhe qytetarë të shumtë, në Gajre, në vendin e rënies, kanë nderuar, në 21-vjetorin e rënies, dëshmorin e UÇK-së, Hetem Hasaj. Kryetari i komunës, Besim Ilazi, ka përshëndetur të pranishmit në këtë manifestim, duke shtuar se rënia e dëshmorëve është simbol i lirisë së vendit tonë. Ai ka thënë se dëshmorët para vetes kishin sakrificën për atdhe, ndërsa pa sakrificën e tyre edhe e ardhmja jonë nuk do të dihej se ç'rrugë do të kishte. Ndërkohë, në emër të Organizatës së Veteranëve të

Luftës së UÇK-së ka folur Hajrush Kurtaj, kryetar i kësaj organizate, i cili ka pohuar se në këtë përvjetor kujtojmë veprimtarinë, vendosmërinë, lavdinë dhe heroizmin e dëshmorit Hetem Hasaj si dhe të gjithë dëshmorëve të tjerë. Në vendin e rënies, pranë lapidarit të ngritur në Gajre, kurora lulesh kanë vendosur kryetari i komunës, Besim Ilazi, bashkë me zyrtarë komunalë, përfaqësues dhe anëtarë të Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, familjarë të dëshmorit etj. Homazhe dhe kurora me lule janë vendosur edhe në Kompleksin Memorial të Dëshmorëve.



Në Malishevë filloi 'Java e Barazisë Gjinore'



MALISHEVË, 2 MARS (ER) - Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Malishevës, Vera Bytyçi, ka njoftuar kryetarin e Malishevës, Ragip Begaj, me aktivitetet që do t'i zhvillohen në "Javën e Barazisë Gjinore", në bashkëpunim me grupin e grave këshilltare në Kuvendin Komunal, Komitetin për Barazi Gjinore dhe Drejtorinë për Arsim dhe Edukim. Kryetari Begaj ka përgëzuar për projektin e "Javës për

Barazi Gjinore", duke ofruar mbështetjen e tij institucionale të plotë në këtë drejtim. "Sot Malisheva ka shënuar rritje në këtë drejtim, që nga punësimi në institucionet, në arsim, shëndetësi, komunë dhe ato në vende përgjegjëse ku udhëheqin femrat, prandaj rezultatet janë të kënaqshme, kështu që presim që në të ardhmen e afërt të kemi përparime edhe më të mëdha

në këtë fushë", ka thënë Begaj. Gjatë tërë javës do të zhvillohen aktivitete me nxënësit e shkollave e ato janë: ese, ekspozita, diskutime me tematikë "Barazia gjinore, hap i sigurt në shoqëri", më pastaj do të vazhdohet me vendosjen e luleve te varri i Nexhmije Pagarushës dhe heroinës Xhevë Lladrovci në Drenas. Në fund të javës më të suksesshmit do të shpërblehen.

'Fehmi Agani' sjell pajisje për persona me nevoja të veçanta në Kamenicë

KAMENICË, 2 MARS (ER) - Shoqata "Fehmi Agani" nga Arendali i Norvegjisë, e përfaqësuar nga Besnik Ramadani, ka sjellë donacion për personat me nevoja të veçanta - pajisje e mjete të ndryshme. Këtë donacion e ka pranuar drejtoresha e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Suna Zaimi-Krasniqi,

e cila u shpreh shumë e lumtur me këtë bashkëpunim. Kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, ka thënë se kontributit të bashkatdhetarëve tanë nga diaspora duhet t'u jenë gjithmonë mirënjohës. "Bashkëpunimet e tilla për përmirësimin e jetesës së kësaj pjese të shoqërisë do t'i

vazhdojmë edhe në të ardhmen", ka thënë Kastrati. E përfaqësuesi i shoqatës "Fehmi Agani", Besnik Ramadani, i cili tash e sa vite është angazhuar të ndihmojë këtë kategori të shoqërisë në Kosovë, ka theksuar se ky nuk do të jetë bashkëpunimi i fundit me Komunën e Kamenicës.



Nis epokë e re në 'Hardh Fest', maratonë festive 96 orë

RAHOVEC, 2 MARS (ER) - Festivali "Hardh Fest" edicionin e kaluar ishte festivali më i vizituar në Kosovë, ku numri i pjesëmarrësve arriti mbi 70 mijë, që shënon numër rekord të ndërkombëtarëve. Festivali me më së shumti turistë në Kosovë, "Hardh Fest", sivjet po vjen me një maratonë festive 96 orë dhe përditësim të aktiviteteve unike, duke i paraprirë vitit jubilar të 20-të. Festivali mbahet më 4, 5, 6 dhe 7 shtator 2020, n'Konak të Rahovecit, bindshëm lokacioni më i madh dhe më modern i festivaleve në Kosovë.

"Hardh Fest" tashmë tradicional, në 19-vjetorin mikson eksperiencat jetësore të turistëve nga mbarë bota, me pamjet vreshtare dhe trashëgimi, me muzikë hip-hop dhe verë rreth kazanit dhe vizita (tours) tradicionale, duke vazhduar me muzikë pop & rock dhe raki rrushi deri te muzika elektronike dhe zjarri në Hardh Camp. Një festival original që tashmë është dëshmuar si përvojë e një dimensionit tjetër, krejt kjo e rrethuar me peizazhet magjepsë vreshtare që përjetojnë vetëm në "Hardh Fest".

Gabimet e politikës shtetërore ndaj turizmit në Kosovë



Shkruan: Erzen GJONBALAJ

Kur fituesi i çmimit Nobel, Herman Hese, u mundua të sqarojë se problemet e reja nuk mund të zgjidhen në mënyra të vjetra, më në fund u kujtua ta gjejë zgjidhjen e këtij problemi dhe atë e shprehu përmes thënies: 'Zogu del nga veza, veza është bota'. Pra, ai që duhet të lindë duhet të shkatërrojë një botë. Mund të thuhet se Hese kishte të drejtë sepse shfrytëzoi kualitetin për ta prekur thelbin e problemit.

Një ndër problemet të cilat mbetën pa hyrë në thelbin e tyre për më shumë se njëzet vjet është fenomeni i turizmit në Kosovë. Ndoshta me "Ardhjen e ditës" do t'u mundësohet aktorëve të procesit të turizmit, qofshin teorik apo praktik, ta shfrytëzojnë kualitetin e tyre për ta prekur këtë fenomen i cili, në suazat botërore, është i shpërndarë në përmasa të gjëra dhe mund ta hasim sot në çdo cep të tokës.

Pse ngeci ky fenomen pa marrë atë çka meriton, mendojmë se problemi ishte në radhë të parë te qasja e politikës shtetërore ndaj këtij fenomeni.

Gabimi më i madh është moskuptimi, çka do të thotë me të vërtetë të udhëhiqet politika turistike e një vendi gjegjësisht moskuptimi i përmbajtjes të atyre detyrave që duhen të kryhen.

Çdokush që gjendet në pozita të tilla duhet të kuptojë se kemi të bëjmë me detyra shumë të ndërlikuara të cilat janë të lidhura me përgjegjësi të mëdha. Sipas rregullave të shkruara, politikën turistike të çdo vendi duhet ta udhëheqë organi kompetent shtetëror (ministra) dhe me siguri personi në nivelin më të lartë hierarkik që është ministri. Në Kosovë një gjë e tillë nuk ekziston por, përkundrazi, është një fenomen i cili vazhdoi duke degraduar turizmin si aktivitet ekonomik në nivelin më të lartë shtetëror.

Dikur, edhe pse nuk ishin ndoshta rrethanat që të ketë një resor ministror i cili do të merrej vetëm me çështjen e turizmit, ekzistoi Departamenti për Hoteleri dhe Turizëm në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Po t'i referohemi mënyrës së udhëheqjes së politikave të turizmit në vendet e rajonit dhe më gjerë, shohim se një pjesë të kompetencave organet më të larta qeveritare që merren me politikën e turizmit e delegojnë drejt organizatave kombëtare turistike të cilën

Kosova as që nuk e ka. Dështimet në drejtimin e turizmit kanë ardhur si mungesë e organeve të tilla të politikave ekzekutive turistike (organ qeveritar) dhe atyre organizativo-propaganduese (Organizata Kombëtare Turistike) apo nga mungesa e njerëzve kompetentë të cilët do mund t'i jetësonin aspektet shkencore në udhëheqjen me aktivitetet turistike në nivelin kombëtar.

Në një kompleks të dështimeve do të duhej të përmendet, sipas mendimit tonë, se disa cilësi dhe karakteristika të tjera që merreshin për bazë që nuk kanë të bëjnë fare me turizmin dhe ishin vendimtare për t'i zgjedhur udhëheqësit të cilët drejtonin turizmin e Kosovës, siç ishte rasti me emërimin e drejtorit të Departamentit për Hoteleri dhe Turizëm në konkursin diskriminues të prillit 2007 i cili nuk kishte asgjë të përbashkët me lëmin e ekonomisë e lërë më atë të turizmit. Puna e prijësit, drejtuesit të organit më të lartë të fushës të turizmit është punë si të gjitha punët e tjerat, por ajo ka specifikat e veta jo vetëm të ketë kualifikime formale, por duhet të ketë aftësi dhe shkathtësi. Së fundi të ketë përvoja specifike në punët e një fushë të tillë. Për fat të keq, ato përvoja dhe shkathtësi nuk i pati asnjëri nga drejtuesit e organit më të lartë qeveritar sa ishte Departamenti për Hoteleri dhe Turizëm dhe ky, ndoshta, ishte shkaku se një organ i tillë u "avullua" dhe mbeti si ngushëllim i tij vetëm Divizioni i Hotelerisë dhe Turizmit.

Me të vërtetë ka qenë vështirë të pritë më shumë kur për emërimet të tilla kanë vendosur personat që nuk kanë asgjë të afërt me turizmin, njerëzit politikë të cilët me dije apo pa dije këtë e bëjnë nga pozicioni politik. Tek ne të jesh politikan do të thotë viafactiçka, do të thotë t'i njohësh të gjitha fushat e jetës njerëzore, pra, je ekspert i të gjitha atyre fushave, dmth. edhe për turizmin, edhe pse në fakt nuk je.

Si shembulli më i mirë i dështimit dhe fillimi i të keqes në drejtimin e fenomenit të turizmit në mënyrë institucionale ishte përzierja e politikës në zhvillimin e turizmit në Kosovë përmes ndërhyrjes në emërimet profesionale që kanë të bëjnë me politikën madhore zhvillimore, shtetërore dhe mospranimi i një programi që ishte për momentin pa alternativë me mundësi të jetësimit deri në 80 për qind i prezantuar para panelit intervistues në prill të vitit 2007. Mospranimi i këtij programi lirisht mund të thuhet se ishte diskriminim i llojit të veçantë dhe çka ishte më e keqja, asnjëri nga anëtarët e panelit intervistues nuk i takonte fushës së ekonomisë.

Ky ishte plani i aktiviteteve që planifikoheshin të realizohen në periudhën 2007 e këndeje në Departamentin për Hoteleri dhe

Turizëm pranë MTI-së:

- Zbatim i politikave të cilat janë prioritete të qeverisë - MTI-së në pikëpamje të zhvillimit të turizmit;

- Përgatitja (përpilimi) e strategjive dhe planeve për zhvillim të turizmit në nivel kombëtar-shtetëror;

- Aplikimi i mekanizmave ligjorë dhe kontrollues për t'i mbrojtur turistët, formimi i inspeksioneve turistike të cilat do ta kontrollonin punën e objekteve të cilat ofrojnë shërbime hotelerie si dhe agjencitë turistike;

- Avancimi i sistemit të edukimit në shkollat e drejtimin të turizmit dhe hotelerisë, me qëllim të plotësimit të nevojave gjithnjë e më të mëdha për burime njerëzore në turizëm dhe hoteleri. Bashkëpunimi me bizneset e ndryshme turistike në qendrat e turizmit si në Ulqin ashtu edhe në qendrat turistike në Shqipëri me qëllim të aftësimit të burimeve të reja njerëzore për punë në turizëm, "kadetëve" të rinj për punë në hoteleri dhe turizëm gjatë zezonës turistike, nxitja e interesimit për nxënësit të cilët kanë suksese të larta gjatë shkollimit paraprak që të çyqen në këtë lëmë;

- Hulumtimi i tregut turistik dhe krijimi i statistikave turistike reale;

- Bashkëpunimi ndërkombëtar në lëmin e turizmit, vënia e kontakteve me destinacionet e njohura turistike në rajon dhe më gjerë, t'u marrim diçka nga arritjet e tyre. (Kryesisht kërkim i mbështetjes nga Republika e Kroacisë);

- Vendosja e sinjalistikës turistike në pjesët e rëndësishme, në nyjat e rëndësishme rrugore, në hyrje të shtetit (mundësisht të gjendet një donator nga jashtë, në shumë raste projektet e tilla janë mbështetur nga donatorët e jashtëm si, p.sh., në Mal të Zi;

- Kujdesi për atraktivitetet turistike kulturore (turizmi kulturor), kujdesi për ruajtjen e monumenteve historike nga e kaluara dhe nga periudha e fundit

- lufta e fundit (turizmi historik dhe turizmi morbil, për fat të keq

u shkatërruan shumë, sidomos faktet nga burgu i Dubravës);

- Organizimi i aktiviteteve promovuese qofshin në mënyrë të drejtpërdrejtë apo përmes shtyllave të tjera të zhvillimit të turizmit;

- Bashkëpunimi me mediumet, me qëllim që ato të mbështesin me informata, në mënyrë që ato të arrijnë sa më shpejt të shfrytëzuesit e shërbimeve turistike, organizimi i emisioneve të karakterit edukativo-arsimor nga lëmi i turizmit sidomos turizmit rural;

- Aktivitete të tjera që mbështesin krijimin e ofertës turistike;

- Kërkimi për Brendin turistik, me të cilin Kosova do të dallohej nga destinacionet e tjera turistike;

- Aftësimi i popullatës lokale për t'u kyçur në rrjedhat e procesit të planifikimit dhe zhvillimit të turizmit rural, kulturor etj. (përmes seminareve dhe trajnimeve të ndryshme);

- Aftësimi-edukimi i animatorëve të turizmit rural dhe integrimi i tyre me mjedisin ku duhet të zhvillohet turizmi rural (kryesisht pjesët rurale të Kosovës);

- Krijimi i një programi shtesë edukativo-arsimor për nxënësit e shkollave në fshat me qëllim që ata të marrin njohuri për vlerat e fshatit të tyre, komunës së tyre me qëllim që të aftësohen për punë në një veprimtari ekonomike e cila premton (turizëm rural, kulturor, shëndetësor etj);

- Organizimi i manifestimeve me karakter turistik nëpër pjesët e ndryshme të Kosovës si, p. sh., një i tillë do të ishte "Karnavali i kujtesës së qytetit" të ngjashëm me disa që organizohen në disa qytete të vogla në Evropën Perëndimore dhe në Bregdetin Adriatik, ku do të merrnin pjesë popullata lokale, mundësisht të gjitha komunitetet sipas moshave së ndryshme...;

- Organizimi i panairëve ku do të prezantoheshin krijimtaritë e karakterit turistik dhe kulturor;

- Bashkëpunimi-mbështetja e shoqatave të ndryshme të cilat me aktivitetin e tyre ndikojnë në krijimin e ofertës turistike si

shoqatat e gjuetarëve, shoqatat e peshkatarëve, shoqatat e kultivuesve të shpendëve etj. Krijimi i kushteve që Kosova një ditë të shpallet vend i gjuetisë dhe të anëtarësohet në organizatat ndërkombëtare të gjuetisë dhe njëherësh të radhitet në destinacionet ekskluzive të turizmit të gjuetisë;

- Pozicionimi i disa zyrave informative të cilat do t'u ofronin turistëve potencialë informata për të cilat ata shprehin interesim;

- Krijimi-publikimi i një "Guide" turistike për turizmin e Kosovës;

- Bregat-kujdesi për ruajtjen e ambientit jetësor (ruajtja e lëndës së parë turistike-ruajtja e llojeve endemike të botës bimore dhe shtazore). T'u kushtohet kujdes më i madh atyre pjesëve të diversiteteve të cilat janë para zhdukjes;

- Zëvendës drejtori i këtij departamenti të emërohet nga komuniteti serb, me qëllim që më lehtë të penetrojmë në kompleksin turistik në Brezovicë;

- Zyra e departamentit do të zhvendosej në Shtërpce me qëllim potencialet turistike për momentin ishin të koncentruara aty, pavarësisht se aty popullata vendore shumicë i përket komunitetit serb. Ky fakt u ilustrua me një shembull nga Mali i Zi, gjegjësisht nga Ulqini, i cili me shumicë popullatë shqiptare, resurset turistike i menaxhon Podgorica, çka dmth. se me Brezovicën duhet të udhëhiqet nga Prishtina çka një zonjë nga paneli intervistues e komuniteti serb nuk i pëlqeu një gjë e tillë dhe si pasojë u "diskualifikua", autori i këtij projekti - kandidatit për kreun e turizmit dhe hotelerisë të asaj kohe dhe kjo ishte arsyeja e mospërfilljes së kësaj ideje dhe që iu komunikua "dikur" gojarisht shumë kohë më vonë nga kryesuesi i panelit intervistues dhe ishte shumë qesharake: "Ja ngrite tensionin zonjës së komunitetit serb".

(Autori është turizmolog-hulumtues i turizmit erotik dhe turizmit rural. **Vijon**)



Peizazhi i bukurive natyrore të Alpeve Shqiptare, pika e tretë e kufirit (KS - AL - MNE). Natyra i dhuroi këto bukuri të cilat njeriu nuk po mund t'i valorizojë. /Foto 08.02.2020. Enes Psk Hrid Drešković)

Britania dhe BE-ja nisin bisedimet për marrëdhëniet pas Brexit-it

BRUKSEL, 2 MARS - Negociatorët britanikë dhe ata të Bashkimit Evropian nisën bisedimet për marrëdhëniet midis dy palëve, pas Brexit-it, apo daljes së Britanisë nga BE-ja. Kryenegociatori evropian, Michel Barnier, dhe homologu i tij britanik, David Frost, u takuan të hënën në Bruksel.

Bisedimet intensive, që do të zgjasin disa muaj, do të mobilizojnë qindra zyrtarë nga të dyja anët. Ato duhet të mbyllen më 31 dhjetor, por shumë vëzhgues thonë se afati është i shkurtër për të arritur ndonjë marrëveshje përmbajtësore për tregtinë.

Kryeministri britanik, Boris Johnson, e ka përjashtuar mundësinë e zgjatjes së periudhës së transicionit. Britania ka dalë nga Bashkimi Evropian më 31 janar. Ajo do të kryejë tregti sikurse vendet e tjera të bllokut, derisa t'i përfundojë periudha transitorë, në fund të këtij viti.



Shanset e demokratëve në Teksasin konservator

Demokrati Bernie Sanders e ka quajtur veten "socialist" dhe paraqitet me një axhendë të madhe dhe të kushtueshme, ndërsa kërkon të jetë kandidati demokrat që do të përballet me presidentin Donald Trump në nëntor

UASHINGTON, 2 MARS - Shteti jugor amerikan Teksas njihet si "Shteti i yllit të vetmuar", për shkak të historisë së tij si një republikë e pavarur. Por, a do t'i përmbahet historisë së tij si një shtet i ngurtë konservator, apo po e pranojnë gjithnjë e më shumë teksanët senatorin e Vermontit, Bernie Sanders? Sanders e ka quajtur veten "socialist" dhe paraqitet me një axhendë të madhe dhe të

kushtueshme, ndërsa kërkon të jetë kandidati demokrat që do të përballet me presidentin Donald Trump në nëntor. Sot (e martë) mbahen votime brenda partive në një pjesë të madhe të shteteve amerikane, duke i dhënë kështu kësaj dite emërtimin 'Super e marta'. Teksasi është disi i ndryshëm, me ritmin e tij të qetë dhe traditat e forta.

"E marrim shumë seriozisht pjekjen e mishit, ashtu si edhe politikën", thotë një teksane. "Ne jemi një shtet i kuq", thotë Gary Buster, banor i Teksasit. Disa mund të thonë "i kuq flakë" për shkak të konservatorëve në këtë shtet. Në vitin 1980, republikani Ronald Reagan fitoi 55% të votave në Teksas dhe në vazhdim mori presidencën. Që atëherë, çdo katër vjet, Teksasi ka votuar për kandidatët republikanë për president. Por tashmë, kjo traditë mund të ndryshojë. Ndërsa Partia Demokratike e këtij shteti ka qenë historikisht e moderuar, Senatori Bernie Sanders, një socialist demokrat që promovon

"Kujdesin shëndetësor për të gjithë", po kryeson në sondazhe. "Ai premtion gjëra shumë të mira, veçanërisht kujdesin shëndetësor", thotë Juanita Loca, e cila votoi për Sandersin. "Mendoj se socializmi demokrat me të vërtetë ua heq fuqinë bizneseve të mëdha dhe ua kthen njerëzve", thotë Anita Basudevan. Të tjerët nuk e shpjegojnë dot sharmin e tij. "Nga krijimi i pasurisë si pjesë e ëndrrës amerikane, tani jemi zhvendosur te ndjesia e turpit nëse jemi të pasur", thotë John Conte, votues republikan. Ekspertët thonë se votuesit e rinj dhe hispanikët do të dalin për të mbështetur Sandersin në 'Super

të martën'. Për dy vjet, hispanikët pritet të bëhen më shumë sesa të bardhët, pra shumica në Teksas. "Të rinjtë, pakicat, do të bëjnë ndryshimin për ta shndërruar Teksasin në blu", thotë Mike Jordan, votues në Teksas. Në gjysmëfinalen e rodeos amerikane, një republikane thotë se mund ta lërë partinë e saj në nëntor për ish-kryetarin e Bashkisë së Nju Jorkut Mike Bloomberg. "Nëse Bloomberg emërohet kandidati demokrat, atëherë do më duhet të marr një vendim të vështirë", thotë Marci Willenborg, votues republikane. Sondazhet e fundit tregojnë se Sanders fiton me 30% të votave, duke ia kaluar ish-nënpresidentit Joe Biden. Konsulenti veteran i Partisë Republikane në Teksas, Craig Murphy, thotë se shifrat e Sandersit nuk përputhen. "Edhe kur humbi përballë Hillary herën e fundit, ai kishte 35%. Pra, ai del me më pak pikë se katër vjet më parë", thotë Murphy. Lupe Valdez është dëshmitare e ndryshimit të votimeve në Teksas. Ajo u zgjodh në kontenë Dallas, dhe u bë sherifja e parë homoseksuale hispanike në Shtetet e Bashkuara. Por, ajo nuk fitoi nominimin për të kandiduar për guvernatorë. Ajo ka mendimin e saj për Sandersin. "Unë mendoj se ai po premtion shumë gjëra për të cilat njerëzit mendojnë se do të bëhen. Por, megjithëse më pëlqejnë idetë e tij, tani mendoj se duhet ta ulë ritmin", thotë ajo për Sandersin. Por, të tjerë mendojnë se duhet lëvizur më shpejt. Sidoqoftë, ky është Teksasi, ku në 'Super të martën', çdo kandidat dëshiron të rrëmbejë shumicën e 228 delegatëve të shtetit.



Erdogani shpreson për një armëpushim në Idlib

ANKARA, 2 MARS - Presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan tha se shpreson të arrijë një marrëveshje armëpushimi për provincën Idlib të Sirisë gjatë bisedimeve që do të ketë të enjten me presidentin rus Vladimir Putin në Moskë. Turqia dhe Rusia mbështesin palët ndërluftuese në konfliktin sirian, i cili është bërë gjithnjë e më i dhunshëm në Idlib

dhe ka çuar në eksodin e një milion njerëzve nga rajoni. Zëdhënësi i presidentit Putin, Dmitry Peskov u tha gazetarëve të hënën se Rusia dhe Turqia po i mbajnë linjat e komunikimit të hapura ndërsa përqendrohen te negociatat. Të dielën, Ministria e Mbrojtjes e Turqisë tha se megjithëse po "vazhdon" me sukses operacionin e saj ushtarak në

veriperëndim të Sirisë kundër forcave siriane të mbështetur nga Rusia, Qeveria turke nuk ka "dëshirë apo synim për t'u përplasur me Rusinë". Ndërkohë, hetuesit e Kombeve të Bashkuara publikuan një raport mbi luftën në Siri ku thonë se Rusia dhe Turqia mund të mbahen përgjegjëse për krime lufte për veprimet e tyre.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

- Quality & Sales Award Recipients**
 [Listed in alphabetical order]
- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
 - ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
 - ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
 - ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
 - ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
 - ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
 - ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
 - ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
 - ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
 - ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



Shijo Pranverën me...

Jaffa Champion PLUS A+C+E Multifrutti

Taste of World Wide Brand!

Jaffa Champion



Samanta Schweblin: Zbuloj errësirën përmes letërsisë

Intervistoi:
Bethanne PATRICK

Si është Berlina sot?

Krejtësisht dimëror! Ka tri ditë që bie borë e cila ka mbuluar gjithçka. Është pamje e këndshme. Më pëlqen Berlina në ditë si këto.

Pse u shpërngulët për të jetuar në Berlin?

Për shkak të një burse njëvjeçare nga bashkia e Buenos Airesit, diçka vërtet e mrekullueshme dhe një gjest bujar. Në fund të saj ishte e vështirë për t'u rikthyer në jetën reale. Megjithatë, erdha në Gjermani me të dashurin tim i cili është argjentinas dhe ndërsa isha e zënë me të shkruarit, ai bëri atë që bëhet zakonisht kur je i papunë: hapi një bar. Ndodhet në Kreuzberg.

A e bën atmosfera në Berlin më të lehtë për të krijuar art?

Në të vërtetë, është shumë ndryshe nga Buenos Airesi, në

aspektin strukturor. E dua shumë Buenos Airesin, por kur erdha këtu, kuptova që mund të punoj më pak dhe të kem më shumë kohë për të shkruar. Këtu mund të organizoj seminare mbi shkrimin tri herë në javë dhe të ardhurat më mjaftojnë për të jetuar.

Më tregoni pak për rrugën tuaj për t'u bërë shkrimtare. Si janë ditët tuaja, tani, si shkrimtare, edhe pse jo shkrimtare me kohë të plotë?

Gjithmonë më tërhiqin librat dhe rrëfimet. Nisa të shkoj në disa seminare letrare kur isha rreth të shtatëmbëdhjetave dhe s'kam reshtur së shkruari që atëherë. Në Argjentinë gjysma e shkrimtarëve organizojnë seminare në shtëpitë e tyre. Si pjesëmarrëse, ishte mahnitëse të mësoja në dhomën e ndenjjes së shkrimtarëve të mi të parapëlqyer, të kisha mundësi të hyja në bibliotekat e tyre dhe të zbuloja një jetë që i përkushtohet të

shkruarit nga kaq afër. Tani, ndërsa jetoj në Berlin, dy herë në javë organizoj seminare mbi shkrimin në dhomën e ndenjjes, duke vazhduar traditën. Ishte një zbulim befasues për mua të shihja se sa shumë njerëz shkruajnë letërsi në Spanjë dhe në Gjermani, dhe e bëjnë kaq seriozisht. Pjesën tjetër të javës jam një shkrimtare me kohë të plotë.

A ka më rëndësi romani? Nëse po, si dhe për kë?

Epo, ka shumë rëndësi për mua. Mendoj se serialët televizivë, lojërat dhe media në përgjithësi kanë ndryshuar mënyrën se si rrëfjmë histori. Por librat do të mbeten. Teknologjia ka ndryshuar të gjitha artet e tjera: pikturën, teatrin, kërcimin, kinemanë, muzikën. Por letërsia është një proces krejtësisht intim ndërmjet zërit të shkrimtarit dhe mendjes së lexuesit, është diçka kaq e natyrshme dhe e fortë, sa e vetmja gjë që teknologjia mund të ndryshojë, është mbështetja e tij,

formati, për shembull, nëse lexojmë një libër të shtypur apo një libër elektronik. Por kjo s'e ndryshon zemrën e letërsisë.

Cilat janë autorët që nuk i lexojnë, por duhet të lexohen nga amerikanët?

Më vijnë kaq shumë emra në mendje, sa është gati e pamundur t'i përgjigjem kësaj pyetjeje. Mësova të shkruaj duke lexuar letërsinë e Amerikës së Veriut, e dashuroj letërsinë tuaj, por kam ndjesinë që nëse një vend lexon vetëm letërsinë që krijon vetë, ai do të mbetet pa oksigjen. E di që këtë vit dy shkrimtare të tjera argjentinas do të përkthehen në anglisht: Leila Guerrero, një kronikane e mprehtë, dhe tregimet e Mariana Enriquez të cilat me subjektet e tyre rrëqethëse dhe të llahtarshme të bëjnë të zgjohesh në mes të natës. Shumë gjëra po ndodhin me shkrimtarët bashkëkohore në Amerikën Latine. Ndoshta kjo do të ishte një pikë e mirë nisjeje.

Cilat janë romanet që do të donit t'i kishit shkruar?

Nganjëherë mendoj "Njeriu i tretë" i Flen O. Brajenit (Flann O'Brien) dhe nganjëherë "Shpikja e Morelit" e Adolfo Bioy Casares.

Cilin autor po lexoni tani? A lexoni letërsi ndërsa shkruani, apo lexoni poezi ose libra joletrarë?

Miq të dhe shkrimtarët janë udhëheqësit e mi më të besuar për sa u përket leximeve. Unë gjithmonë mbaj parasysh rekomandimet që më japin njerëz që më duken interesantë. Nganjëherë s'janë shkrimtarë dhe librat e tyre të parapëlqyer nuk janë letërsi, por ide të mëdha që mund të burojnë prej saj.

Meqë ra fjala tek idetë e mëdha, libri juaj është theksuar nga shumë kritikë se nuk është një libër i zakonshëm. A ishte kjo e qëllimshme? A synonit të shkruanit diçka të ndryshme?

Është e vështirë t'i përgjigjesh, por do të përpiqem. Për mua, krijimi i

tensionit është një nga gjërat më të rëndësishme gjatë leximit dhe të shkruarit. Kam nevojë për këtë tension si lexuese, por gjithashtu kam nevojë për të kur po shkruaj ose kur s'mundem të vijoj të punoj me librin. Kur e filloj një libër, që nga ideja më e parë, me të vërtetë që kam nevojë të ndiej që ajo që po bëj është diçka vërtet e re, sepse nëse nuk është, nuk është e mundur që ajo që po shkruaj të marrë vëmendjen time. Kur isha e vogël dhe ende s'kisha mësuar të shkruaja, e kisha zakon t'i rrëfeja histori nënës sime. Isha afërisht pesë ose gjashtë vjeçe dhe çdo natë i tregoja histori. Më kujtohet që zbuloja ndjesinë që isha në gjendje të prekja me të vërtetë dikë tjetër me historitë e mia dhe çka është edhe më e mira, nëse sajoja diçka vërtet dramatike, kjo do të thoshte se mund ta shndërroja historinë dhe të tërhiqja vëmendjen ndërkohë që e doja kaq shumë atë. Nuk janë të shumta çastet në jetë kur dikush tjetër do të të dëgjojë, kur ti arrin të rrokësh plotësisht vëmendjen e tij. Është një ndjenjë magjepsëse dhe kur jam duke shkruar, përpiqem ta përjetoj këtë çast.

Le të flasim pak për rolin e kafshëve në "Largësi shpëtimi", për rolin e kuajve dhe insekteve. Dua ta tregoj këtë lloj fuqie që ato

kanë, gjithashtu ngaqë Davidi ka informacion të cilin ne nuk e kemi, e kam fjalën për ne lexuesit dhe për Amandën. Ai di shumë për vdekjen dhe në një vend ku njerëzit po vdesin nga kimikatet, edhe kafshët po vdesin. Davidi e ka këtë fuqi për të ndihmuar ata që po vdesin. Ai e ka këtë marrëdhënie me të gjitha gjërat në botë mes jetës dhe vdekjes, të gjitha gjërat që janë në një lloj purgatori.

Jam prind dhe më pëlqeu shumë ideja e "largësisë së shpëtimit", tërheqja që Amanda thotë se ndien sa herë që e bija është larg saj.

Doja të jepja një ngjyresë të veçantë, vërtet të veçantë, të kësaj ideje që nëse do të vijë fundi i botës, ai do të fillojë nga nëna. Lidhja me Davidin është ajo lidhje që ekziston kur gjërat bëhen aq të trishtuara sa të përmbledhësh të gjitha fatkeqësitë e botës, kur çdo gjë është e tmerrshme, drama e vogël e dy ose tri personazheve mund të jetë me të vërtetë e rëndësishme. Mund të jetë fillimi i diçkaje me të vërtetë të thellë, ku një pyetje e thjeshtë të ndihmon të dish ku fillon e keqja dhe nëse e di se ku është e keqja, mund ta luftosh atë. Kur kjo ndodh, çdo gjë bëhet e rrezikshme. Kjo është arsyeja që

"largësia e shpëtimit" prishet: çdo gjë në botën ku jeton Amanda është e rrezikshme.

Pse përqendrohet ky roman te nënat dhe jo te baballarët?

Mendoj se kjo është e lidhur me jetën time. Në kujtesën time, burrat në familjen time ishin të dobishëm në shumë mënyra, si për shembull duke bartur gjëra të rënda, ndërsa kur nuk shkonte diçka që lidhej me shpirtin, emocionet, ishin gratë ato që merreshin me këtë gjë. Kjo jo ngaqë burrat s'donin t'ia dinin, por sepse s'e kuptonin dhe s'mund të dukeshin sikur po merreshin me gjëra të tilla. Në fund të "Largësi shpëtimi", kur të gjitha gratë kanë ikur, të vetmit që mbeten janë dy baballarë të cilët duan të përkuajdesen, por që nuk arrijnë të krijojnë vërtet komunikim.

Pse Davidi këmbëngul t'i thotë Amandës që "kjo s'ka rëndësi" për të vijuar ecjen përpara? Çfarë do të thotë kjo?

Kur po shkruaja librin, shumë herë kisha ndjesinë që Davidi i kërkon Amandës të vazhdojë përpara, që ai në të vërtetë po më kërkonte mua ta bëj këtë, duke më thënë të vija me këtë mënyrë të ndryshme të shkruarit. Një metaforë interesante për atë që ia vlen dhe nuk ia vlen ta

thuash! M'u desh kohë të gjeja zërin e Davidit. Shkrova afërisht dymbëdhjetë fillime të ndryshme, prej pesë ose gjashtë faqesh secili, duke u përpjekur të gjej zërin e rrëfimitarit. Në fund të atij procesi dëgjoj zërin e Davidit që flet me Amandën. Në fillim mendova që dialogu i tyre do të ishte pjesë e romanit. Pastaj kuptova që dialogu ishte romani. Ishte vetë historia që më tregoi se si ta rrëfeja.

Sëmundja dhe shkatërrimi global janë probleme globale. A mund të ndodhnin ngjarjet e romanit tuaj diku tjetër, apo mund të ndodhnin vetëm në Amerikën Latine?

Kjo histori mund të ndodhte kudo. Në të vërtetë, hera e parë që dëgjova për pesticidet dhe pasojat e tyre të tmerrshme ishte nëpërmjet një dokumentari mbi këtë temë në Francë. Por, para së gjithash, për shkak të korrupsionit Amerika Latine ka ligjet dhe marrëveshjet më të këqija me kimikatet. Dhe Argjentina, sidoqoftë, është një nga importueset më të mëdha të sojës, një nga produktet më të lidhura me pesticidet. Ne e shpërndajmë këtë sojë në të gjithë botën, është baza e një pjese të madhe të ushqimit tonë. Soja është gjithçka: biskotat,

peshqit e ngrirë, buka, supat dhe të gjitha llojet e miellit, madje edhe e akullores!

Si shihet situata e tanishme politike amerikane në Gjermani, Europë dhe në pjesën tjetër të botës?

Mendoj se ne të gjithë jemi vërtet të shqetësuar. Këtu në Gjermani, rrethi im i miqve nuk është i lumtur me Donald Trump-in si presidenti i ri i Shteteve të Bashkuara, megjithëse e djathta europiane e simpatizon atë. Dhe si një latino-amerikane ju siguroj që e djathta populiste mund të jetë vërtet e rrezikshme.

Ai i flet një libër si yti politikës moderne më shumë se një libër joletrar? Pse po ose pse jo?

Po, i flet politikës moderne, por në një mënyrë të ndryshme. Letërsia nuk mund të jetë informuese, didaktike apo indoktrinuese, por mund të lërë një gjurmë të vërtetë në frikërat e tua, mund të hapë dritare në mendjen tënde, të të bëjë të vësh në dyshim diçka për të cilën s'ke menduar kurrë më parë. Dhe nganjëherë kjo është po aq e rëndësishme sa një informacion aktual, madje edhe më i besueshëm./Exlibris.al

*Përktheu nga anglishtja
Granit ZELA*



E rrallë

Krijesa e pazakontë me dukje të ngjashme si krokodili dhe peshku

Derisa po shëtiste pranë një kanali në Risca të Wales, Caroline Brown ka hasur në një krijesë shumë të pazakontë. Ishin mbetjet e një peshku të çuditshëm, me fytyrë sikur të krokodilit, derisa kishte gjatësi deri në një metër. Ngjashmëria e krijesës ishte me një lloj krokodili të vogël që gjendet rrallë në Shtetet e Bashkuara, derisa ishte shumë e habitshme se si përfundoi në një kanal në Britani të Madhe.



FOTO E DITES



Disa vullnetarë me kostume mbrojtëse në provincën Hunan në Kinë shihen duke dezinfektuar një stacion hekurudhor si shkak i koronavirusit. /Reuters/

E jashtëzakonshme

Banorët kur zgjohen gjejnë shtëpitë e mbuluara nga akulli

Për dikë tjetër është një mrekulli e vërtetë dimri, por banorët e zonës së Lake Erie në shtetin e Nju Jorkut u zgjuan këtë fundjavë e përjetuan një makth: shtëpitë e tyre ishin mbuluar plotësisht nga një akull i trashë. Siç tregon për "CNN", një prej banorëve, Ed Mis,



veshje akulli, shtëpitë e tyre kanë pasur edhe në të kaluarën, por kurrë në këto përmasa. "Duket si e rreme, si joreale, por ju siguroj se pamjet janë më se të vërteta", u shpreh ai.

BARSOLETA E DITËS



- Më falni, sa më kushton të më dërgoni deri në aeroport?
- 25 euro.
- Po nëse e marr edhe femrën me vete?
- Njëjtë, 25.
- A sheh zemër se ti nuk vlen asnjë cent.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 18:00 Spies in Disguise 3D

I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

Rolet: Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

Regjia: Troy Quane, Nick Bruno



Në ora 18:00 Jumanji; The Next Level 3D

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min
Rolet: Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.
Regjia: Jake Kasdan




Çdo natë në ora 20:00

STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min

Rolet: Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj.
Regjia: J.J. Abrams



Çdo natë në ora 22:30

THE GRUDGE

Horror/Mister; 1 orë 34 min

Rolet: Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea Duvall and Bill Pullman

Regjia: Takashi Shimizu



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, **fb: Kino ABC.**



DASHI

Të lindurit e kësaj shenje do të kenë fat me financat.


Do t'ju shlyejnë një borxh, të cilin kishit kohë që jua kishin marrë.



DEMI

Demet rekomandohen ta kalojnë ditën jashtë.

Vizitoni të afërmit dhe miqtë tuaj të ngushtë. Mund të shëtisni ose të merrni pjesë në një ngjarje të organizuar pranë lagjes suaj.



BINJAKËT

Binjakët rrezikojnë ta kalojnë këtë ditë duke u

përfshirë në disa çështje pa rezultat. Ka gjasa të shpenzoni shumë kohë duke u marrë me biseda boshe.



GAFORRJA

Gaforret nuk rekomandohet të

ndërmarrin udhëtime të lodhshme. Rrezikoni që gjendja juaj e përgjithshme emocionale t'ju shkaktojë panik.



LUANI

Disa luanë do të dëshirojnë të ndryshojnë. Megjithatë,

rekomandohet të bëni shumë kujdes. Ka gjasa se për shkak të veprimeve të nxituara, do të shpenzoni shumë para ose mund të përjetoni probleme shëndetësore.



VI RGJËR ESHA

Të lindurit e kësaj shenje do të kenë nevojë të

përqendrohen te disa probleme shëndetësore. Analizoni bisedat e mëparshme me persona që ju i konsideroni aleatë.



PESHORJA

Peshoret ka mundësi të mos kalojnë një ditë

aq të këndshme sa e kishin menduar. Ndoshta një moment i veçantë që prisnit të ndodhte, nuk do të jetë në lartësinë e duhur.



AKREPI

Disa akrepa do të duhet të punojnë

fort nesër. Ka gjasa që për shkak të disa rrethanave, ta harroni veten dhe të ndihmoni një mik të ngushtë.



SHIGJETARI

Rekomandohet të mos tregoheni të

sinqertë me të gjithë. Naiviteti nuk është i mirëpritur kur komunikoni me persona që ju kanë trajtuar gjithnjë me zili.



BRICJAPI

Tregohuni shumë të kujdesshëm me

shëndetin. Shmangni një punë që mund t'ju sjellë lodhje të tepërt mendore dhe fizike.



UJORI

Gjatë kësaj dite ujqorët

mund të përballen me disa probleme. Pasdite atmosfera do të ndryshojë duke u bërë më e qetë.



PESHQIT

Peshqit nuk duhet të shpenzojnë

shumë energji për gjera që nuk janë të dobishme. Rekomandohet ta shpenzoni ditën në një rreth me persona të afërt.

Këngëtarja e metrosë nuk ndalet



Charlotte Awbery, këngëtarja që u bë e famshme brenda natës pasi u ndal nga gazetari i mediave sociale Kevin Freshwater në metro për një lojë të njohur si "Finish The Lyrics", ka mahnitur sërish. Awbery ishte duke dalë me shoqërinë dhe ishte duke


ecur nëpër London Tube (transporti nëntokësor i Londrës) kur u ndal nga Kevin i cili i kërkoi ta vazhdonte tekstin e këngës "Shallow" nga filmi "A Star is Born". Awbery e vazhdoi këngën tejet bukur dhe klipi i publikuar më pas u bë viral.

Jennifer Lopez flet pasi nuk mori çmim "Oscar"



Oscari i këtij viti ishte i "dhimbshëm" për Jennifer Lopezin më shumë se të tjerët. Për filmin e saj, "Hustlers" s'u dha asgjë tjetër veç mospërfilljes. Për herë të parë, ylli 50-vjeçar pranon hapur se ky fakt e ka lënduar. "U mërzita! U mërzita pak sepse dhashë

shumë për ta ndërtuar. Mora shumë feedback pozitiv të them të drejtën dhe kishte shumë nga ata që mendonin se do të nominohesha për Oscar. Thashë se do të ndodhte vërtet. Nuk ndodhi dhe u ndjeva keq. U ndjeva si e lënë në baltë", ka thënë Jennifer Lopez.



Rita Ora merr masat kundër koronavirusit

Këngëtarja shqiptare Rita Ora ka udhëtuar për në Francë për Javën e Modës në Paris. Rita Ora gjatë kësaj rruge ka ndërmarrë masa mbrojtëse ndaj koronavirusit. Ajo e ka publikuar një fotografi në "InstaStory", në të cilën shfaqet

me një maskë mbrojtëse. Virusi vdekjeprurës që ka marrë jetën e më shumë se 3 000 njerëzve dhe afro 90 000 mijë të tjerë janë të infektuar (numri më i madh në Kinë), është përhapur edhe shumë vende evropiane.

Oprah Winfrey rrëzohet në skenë



Oprah Winfrey është përballur me një moment të sikletshëm në paraqitjen e fundit. Një nga gratë më me ndikim në botë është rrëzuar në

skenë. Moderuesja e njohur ka qenë duke folur në Los Anxhelos në kuadër të fjalimeve të saj për mirëqenien, në momentin kur ndodhi ngjarja.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com




QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Gashi: Mbijetesë nuk diskutohet

Sulmuesi Dren Gashi për "Epokën e re" ka thënë se Ferizaj ka synime që të marrë rezultat pozitiv kundër Prishtinës të mërkurën në kryeqytet. "Këto pikë mendoj se na këndellen sadopak për ta vazhduar luftën e ashpër që do të bëhet midis skuadrave të Superligës për të mbetur pjesë e rangut elitare edhe në edicionin e ardhshëm. Sigurimi i mbijetesës do të jetë i vështirë, por në fund besoj se do t'ia dalim", ka thënë Gashi

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 2 MARS - Skuadra e Ferizajt është paraqitur mirë në ndeshjen e fundjavës kundër Llapit, pasi ka shënuar fitore me rezultat 2-0. Të dyja golat i realizoi sulmuesi Dren Gashi, i cili për "Epokën e re" ka thënë se tri pikët e fituara janë shumë të vlefshme dhe motivuese për klubin që ta vazhdojë garën për mbijetesë në elitën e futbollit të Kosovës. "Këto pikë mendoj se na këndellen sadopak për ta vazhduar luftën e ashpër që do të bëhet midis skuadrave të Superligës për të mbetur pjesë e rangut elitare edhe në edicionin e ardhshëm. Sigurimi



i mbijetesës do të jetë i vështirë, por në fund besoj se do t'ia dalim", ka thënë Gashi.

Skuadrën e Ferizajt e pret edhe një tjetër derbi në mesjavë, pasi të mërkurën do të luajë kundër Prishtinës në stadiumin "Fadil Vokrri", derisa Gashi beson se mund të marrin rezultat pozitiv në këtë sfidë. "Ndeshjen e radhës e keni shumë të vështirë kundër Prishtinës. Synimet ndaj ish-skuadrës sime janë të qarta si për mua, po ashtu edhe për klubin që të dalim pozitivisht nga kjo ndeshje që do të jetë e vështirë, pasi që Prishtina po kalon nëpër formë të mirë dhe është një skuadër me traditë të madhe në futbollin e Kosovës", ka thënë Gashi.

Garën për mbijetesë Ferizaj do ta

zhvillojë kundër Vushtrrisë dhe Dukagjinit që i ka lënë pas në renditjen tabelore, por edhe me Trepçën '89 dhe Drenicën që janë dy pozita më lart. Futbollisti në fjalë mendon se nuk do të kenë problem që të dalin më të suksesshëm se skuadrat e lartpërmendura. "Mendoj se do ta shkatërrojmë secilën skuadër që na del përpara në secilën lojë të ardhshme, sepse çdo pikë e fituar do të jetë e artë në rrugën drejt arritjes së objektivit kryesor për të qenë pjesë e Superligës edhe në edicionin 2020/2021", ka përfunduar ai.

Pas njëzetë xhirove të zhvilluara, Ferizaj renditet në pozitën e dhjetë me 22 pikë të grumbulluara, ku ka regjistruar shtatë fitore, një barazim dhe dymbëdhjetë humbje.

SHKURT

Flamurtari arrin fitore të rëndësishme ndaj Vushtrrisë

Ndeshja e fundit e javës së 20-të në IPKO Superligë është zhvilluar të hënën. Flamurtari ka shënuar fitore tejet të rëndësishme në duel me Vushtrrinë, me rezultat 2-0. Të dy golat kuqezinjët e kryeqytetit i realizuan në fund të pjesës së parë. Fillimisht shënoi Bashkim Shala në minutën e 40, kurse një minutë më vonë realizoi Arbnor Zeqiraj. Në pjesën e dytë mysafirët nga Vushtrria ishin më të mirë, por nuk ia dolën ta konkretizojnë asnjë prej rasteve të krijuara. Pas kësaj fitoreje Flamurtari del nga zona që dërgon në një rang më të ulët të garave, duke u pozicionuar në vendin e 8-të me 25 pikë, derisa Vushtrria mbetet në pozitën e parafundit, me 15 pikë.

38 milionë euro është klauzola e Rashicës

Ylli i Kosovës, Milot Rashica, ka kaluar nëpër një formë fantastike këtë edicion, por që skuadra e tij, Werder Bremen, nuk ka pasur rezultatet e duhura dhe rrezikon rënien në Bundesliga 2. Mediat gjermane kanë raportuar se Werderi do të shesë shumë futbollistë pasi është në një krizë të madhe. Vetëm mbetja në Bundesliga shpëton nga një krizë më e madhe klubin me traditë të gjatë në futbollin gjerman. Mediat gjermane kanë zbuluar edhe klauzolën që ka Rashica te Werderi e cila është 38 milionë euro, por kjo klauzolë është vetëm për skuadrat jashtë Gjermanisë që duan ta transferojnë Rashicën.

Më 4 e 5 mars turneu 'Adem Jashari' në futsall

Federata e Futbollit e Kosovës edhe sivjet do ta organizojë turneun tradicional në futsall "Adem Jashari". Komisioni për futsall i ka bërë të gjitha përgatitjet për organizimin e edicionit të 11-të të këtij turneu, i cili do të mbahet më 4 dhe 5 mars në Pallatin e Rinisë dhe Sportit në Prishtinë. Pjesëmarrës të turneut të sivjet-më do të jenë Liburni (kampion i Kosovës në fuqi), Prishtina 01 (fituese e Kupës së Kosovës), Shkupi dhe Ulqini. Shorti për ndeshjet gjysmëfinale do të tërhiqet para hapjes solemne të këtij turneu, kurse ndeshjet do të zhvillohen prej orës 18:00 dhe prej orës 20:00. Vitin e kaluar trofeun e këtij turneu e fitoi Mabetex Prishtina.

Çitaku zë vendin e parë në kampionatin e pingpongut në Lihtenshtajn

Më 1 mars me një atmosferë sportive është mbajtur kampionati individual i pingpongut për senior në Lihtenshtajn, ku ish-lojtari i KPP Prishtina, Linor Çitaku, zuri vendin e parë. Ai tregoi formën e tij më të mirë duke shënuar të gjitha fitoret bindëse, ku në finale u ballafaqua me kampionin e Lihtenshtajnit, Asad Keucheyan, të cilin e mposhti me rezultat 3-0. "Për mua është kënaqësi që dola i pari në Kampionatin Kombëtar 2020, ku edhe mposhta në finale kampionin e Lihtenshtajnit. Në këtë kampionat kishte konkurrencë të madhe me që kishte lojtarë edhe nga shtetet fqinje, edhe nga Zvicra", ka thënë Çitaku.

Topalli: Ballkani e mposhtë Dritën edhe pa mua

SUHAREKË, 2 MARS - Sulmuesi Jetmir Topalli nuk do të luajë në ndeshjen ndaj Dritës për shkak të kartonëve. Ai ka thënë për "Epokën e re" se i mbetet shumë merak se nuk do të ketë mundësi t'i ndihmojë skuadrës në këtë ndesh-

je shumë të rëndësishme, por beson se Ballkani do të dalë triumfues. "Nuk do të jem pjesë e Ballkanit në ndeshjen ndaj Dritës për arsye se kam mbushur numrin e kartonëve. Më mbetet merak se nuk do të kam mundësinë t'u

ndihmoj bashkëlojtarëve, pasi është një ndeshje derbi me rëndësi të madhe. Megjithatë, besoj se kushdo që luan në vendin tim do të japë maksimumin dhe Ballkani në fund do t'i gëzohet fitores", ka deklaruar Topalli.



Ronaldo dëshiron të rikthehet në Real Madrid

MADRID, 2 MARS - Ylli portugez i Juventusit, Cristiano Ronaldo, ka shprehur dëshirën që sërish të rikthehet në Real Madrid. Lajmin e ka konfirmuar gazetari Edu Aguirre, i cili është mik i yllit por-

tugez dhe kjo e përforcon gjithmonë e më shumë idenë e rikthimit të Ronaldos në "Santiago Bernabeu". Ronaldo ishte i pranishëm në "Santiago Bernabeu", ku ndoqi nga afër "El Clasico"-n,

ndërkohë që iu rezervua një pritje e ngrohtë. "E di me siguri se Ronaldo ka një dëshirë të kthehet të luajë për Real Madridin. Ai ndjeu një afekcion të veçantë nga tifozët madrilenë kur erdhi në

'Santiago Bernabeu'. Tani për tani ai është i fokusuar i gjithi te Juventusit, por në futboll kurrë nuk thuhet kurrë. Nuk e dimë se çfarë do të ndodhë në të ardhmen", ka thënë Aguirre.



Pesë shtete marrin pjesë në turneun ndërkombëtar në Prishtinë

PRISHTINË, 2 MARS - Nga 13 deri më 16 mars në Prishtinë do të organizohet turneu në basketboll për Zhvillimin e Gjeneratave të Reja (YDF) të FIBA Evropës. Në këtë turne do të marrin pjesë: Kosova, Maqedonia Veriore, Turqia, Rumania dhe Bullgaria. Turneu do të jetë në të dyja konkurrencat për kategorinë U15. Pra, pesë shtete marrin pjesë me ekipet e djemve dhe vajzave. Ndeshjet për katër ditë me radhë do të zhvillohen në Pallatin e Rinisë dhe Sportit në Prishtinë dhe palestrën '1 Tetori'. Turneu më parë ishte organizuar në Rumani, Bullgari dhe Maqedoninë Veriore, derisa pas Kosovës do të organizohet në Turqi gjatë qershorit të këtij viti. Basketbollistët dhe basketbollistët e Kosovës do të mund të fitojnë përvojë nga ky turne dhe të jenë të gatshëm për



përfaqësueset e reja të Kosovës. "Federata e Basketbollit e Kosovës tash e katër vjet është pjesë e projektit të FIBA-s për Zhvillim të Gjeneratave të Reja, por në vitin 2019

projekti ka filluar të implementohet edhe për vajza, gjë që shërben në dobi të zhvillimit të basketbollit në konkurrencën e femrave", thuhet në njoftimin e FBK-së.

Lakersat ruajnë kreun në Konferencën e Lindjes

NEW ORLEANS, 2 MARS - Skuadra e Lakersave nuk e ndal rrugëtimin në Konferencën e Lindjes, duke ruajtur kreun edhe pas fitores 122-114 ndaj New Orleansit. Sfidë ku herë udhëhiqte njëri ekip e herë tjetri, por në minutat e fundit mysafirët nga Kalifornia u shkëputën. LeBron Jamesi realizoi një "triple double", me 34 pikë, 12 rebounde e 13 asistime, mbështetur nga Kuzma me 20 pikë (Davis ishte pushim). Në kahun tjetër u dallua Williamsoni me 35 pikë, por që mbetën për statistikë. Fiton edhe skuadra tjetër e Los Anxhelosit, ajo e Clippersave, që mundi me rezultat 136-130 Philadelphian, sfidë e vendosur në periodën e fundit për vendasit.



Leonard realizoi 30 pikë, ndërsa tre lojtarë e mbyllën me nga 24 pikë: George, Harrell e L. Williams. Skuadra e Denverit arriti fitore me rezultat 133-118 ndaj Torontos, dy ekipe pretendente në konferencat përkatëse. Denveri e dominoi ndeshjen, me Jokiçin protagonist me një "triple double" (23 pikë, 18 rebounde e 11 asistime). Renditjen e përgjithshme të NBA-së e kryeson

Milwaukee, që fitoi me rezultat 93-85 ndaj Charlottes, sfidë me rivalitet shumicën e kohës. Ndeshje e mirë e Antetokounmpo, që realizoi 41 pikë e 20 rebounde. Dallasi, falë 38 pikëve e 13 reboundeve të Porzingis, mundi 111-91 Minnesotan, ndërsa Washingtoni triumfoi me rezultat 124-110 ndaj Golden State, me Beal autor të 34 pikëve.

REZULTATET

Charlotte - Milwaukee	85-93
Minnesota - Dallas	91-111
Clippers - Philadelphia	136-130
Denver - Toronto	133-118
Sacramento - Detroit	106-100
New Orleans - Lakers	114-122
Golden State - Washington	110-124

Koronavirusi shtyn fillimin e sezonit edhe në Moto GP

Koronavirusi bëhet një faktor përcaktues edhe në Moto Grand Prix. Pas shtyrjes së Formulës, edhe starti i sezonit në klasën mbretërore të garave me motorë është shtyrë. Sezioni i ri nuk do të fillojë më 8 mars siç ishte në program me Çmimin e Madh të Katarit. Situata e krijuar së fundmi dhe masat që ka marrë shteti i Katarit duke bllokuar flu-

turimet nga shumë vende, përfshirë edhe Italinë nga e cila vijnë një pjesë e madhe e skuadrave, ka sjellë këtë vendim të Organizatës Botërore të Automobilitimit. Të vetmet gara që do të zhvillohen janë ato të Moto2 dhe Moto3, pasi skuadrat gjenden prej disa ditësh në Katar për shkak të pjesëmarrjes në testet dimërore në këtë pistë. Në një situ-

atë të ngjashme është edhe zhvillimi i garës së dytë, Çmimit të Madh të Tajlandës që është planifikuar më 22 mars, pasi shteti atje ka vendosur shumë masa të repta për udhëtimet nga vendet e prekura nga koronavirusi, kështu që sezoni i ri i Moto GP pritet të nisë me disa javë vonesë. Ndoshta gara e parë mund të zhvillohet edhe në muajin prill.

SHKURT

Shehi, trajner i Kukësit

Orges Shehi është zyrtarisht trajneri i ri i Kukësit. Ish-portieri i njohur ka firmosur deri në vitin 2021, teksa objektivi kryesor është fitimi i titullit kampion gjatë këtij sezoni, me verilindorët që janë 4 pikë larg nga Tirana. "Klubi i Kukësit njofton se ka arritur marrëveshje me trajnerin Orges Shehi për ta marrë drejtimin e skuadrës. Pas bisedimeve që klubi ka pasur me teknikun, është gjetur gjuha e përbashkët dhe Shehi ka firmosur me Kukësin deri në verën e vitit 2021! Në ambientet e "Air Albania", Shehi është prezantuar nga administratori Lavdrim Gjici dhe drejtori Sportiv, Nderim Nexhipi. Shehi në karrierën futbolistike ka arritur të fitojë trofe të shumta me Skënderbeun si dhe numëron paraqitje në grupet e Ligës së Evropës. Aventura si trajner nisi një vit më parë, kur për një sezon drejtoi skuadrën e Skënderbeut", thuhet në njoftimin e Kukësit.

Pique: Na mposhti Reali më i dobët, me të cilin jam përballur në 'Bernabeu'

Gerard Pique beson se Barcelona humbi ndaj Real Madridit më të keq, me të cilin është përballur në kryeqytet, ndërsa Barça doli e mposhtur 2-0 nga "El Clasico" e së dielës në mbrëmje. "Në pjesën e parë ishte Real Madridi më i dobët, me të cilin jam përballur në 'Bernabeu'. Ne humbëm një shans për ta ndëshkuar. Duhet të luajmë më mirë se në pjesën e dytë. Humbëm shumë topa dhe kjo i dha vetëbesim kundërshtarit. E përsëris, Reali më la përshtypjen më të keqe të mundshme në pjesën e parë dhe këtë nuk e them si kritik. Të gjithë kemi probleme në klubet tona, por mendoj se humbëm një mundësi të rëndësishme", ka thënë Pique. "Vështirë ta gjejmë më Real Madridin në këtë gjendje. Ende kemi hapësira për mirësimi. Mund ta fitojmë La Ligën nëse i bëjmë si duhet gjërat deri në fund të sezonit. Kurdoherë që të humbësh në 'Bernabeu' do të lëndohesh për shkak të rëndësisë së lojës, pikëve... nëse do të fitonim, ishte një hap i rëndësishëm", ka shtuar Pique.

Milani planifikon rikthimin e Capellos

Milani do të ketë shumë ndryshime sa i përket sezonit të ardhshëm atje ku, sipas të gjitha gjasave, do të largohet edhe trajneri Pioli, nëse nuk përmbushen objektivat e klubit. Mediat italiane raportojnë për një rikthim të Fabio Capellos te Milani. Ky i fundit është shumë i vlerësuar në Itali, ndërsa pritet që të emërohet drejtor teknik. Një skenar që nuk mund të përjashtohet te kuqezinjët, ndërsa bëhet fjalë për një emër që e njeh prej vitesh funksionimin e kjo skuadër.

Sturridge ndahet me Trabzonsporin

Sulmuesi anglez Daniel Sturridge ka ndërprerë bashkëpunimin me klubin turk Trabzonspor me pajtim të dyanshëm, vetëm tetë muaj pasi firmosi kontratë trevjeçare, raportojnë mediumet turke të hënën. Sturridge iu bashkua Trabzonsporit si lojtar i lirë në verë, pasi i mbaroi kontrata me Liverpoolin. Mirëpo, është marrë vendim për ndërprerje të bashkëpunimit, ndonëse Sturridge luajti në ndeshjen e fundit. Ai luajti 55 minuta kundër Beshiktashit ndonëse nuk shënoi gol. Sturridge ka realizuar katër gola në 13 ndeshje për Trabzonsporin këtë stinor. Sulmuesi anglez me gjasë duhet të presë deri në verë për të firmosur për një klub tjetër.



Lume's Details
Estetik & Depilim

Fatlume Shabani

☎ 044 900 978 | 045 681 898
 📍 Sallon Depilimi Lume's Details
 📷 lumesdetails
 📍 Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

Salloni i Depilimit 'Lume's Details' në Prishtinë kërkon një praktikante e cila pastaj mund të punësohet me pagesë nëse tregon rezultat të mirë gjatë kohës së praktikës.

Të interesuarat mund të paraqiten në këta numra kontaktues: 045681898 dhe 044900978


RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 📞 +386 49 848 553

PRISHTINË



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

www.facebook.com/gjejpuneshpeite

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Ruzhdi Kosumi shpall të pavlefshme diplomën e Bachelorit të Fakultetit Ekonomik drejtimi Banka Financa dhe Kontabilitet në UP.
- ▶ Erza Topallaj shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme gjimnazi "Hamëz Jashari" Skenderaj.
- ▶ Isa Kuqani shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme teknike "Anton Çetta" Skenderaj.
- ▶ Berat Kabashi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Q.K.S Skenderaj.
- ▶ Vera Qamil Krasniqi, lindur më 13.08.1983, shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme profesionale "Hysni Zajmi" në Gjakovë. Po ashtu, i shpall të pavlefshme edhe certifikatat e viteve shkollorë; I, II, III dhe IV. Diploma dhe certifikatat janë lëshuar nga administrata e UNMIK-ut.
- ▶ Vera Qamil Krasniqi, shpall të pavlefshme diplomën e studimeve themelore në fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës, drejtimi Marketing. Viti i regjistrimit 2003/2004 dhe përfunduar në vitin 2008.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- ▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- ▶ Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- ▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.
- ▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- ▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.
- ▶ Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.

Shes truallin prej 36 arë në fshatin Besi; 150 metra nga magjistrallja Prishtinë-Besianë. Trualli ka gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe është shumë i përshtatshëm dhe për banim kolektiv. Po ashtu lëshojmë me qira vendin për restorant me një pamje atraktive dhe piktoreske me në një lartësi të madhe mbidetare.

Tel. 044-413-197.



Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës
Press Council of Kosovo
Savet Stampe Kosova

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK)

Kuvendi i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës, me datën 02 mars 2020 shpall konkurs për pozitën:

Drejtor ekzekutiv i KMSHK-së

Data e fillimit	01 prill 2020
Përfundimi i kontratës	31 mars 2021 (me mundësi vazhdimi)
Puna provuese	3 muaj nga data e fillimit të punës
Shpallja e pozitës	02 mars 2020
Afati për aplikim	10 ditë prej shpalljes së konkursit

Në bashkëpunim me Kuvendin e Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës dhe në koordinim të plotë me sekretarinë e KMSHK-së, i punësuar kryen të detyrat në vijim:

- Drejton Zyren e Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK) me integritet të lartë profesional e personal, në përputhje të plotë me statusin e tij si institucion i pavarur;
- Në përputhje të plotë me Statutin e KMSHK-së dhe rregulloren e brendshme udhëheq organizatën, e përfaqëson atë dhe merr vendime në lidhje me detyrat dhe të drejtat që ka;
- Udhëheq, menaxhon dhe mbikëqyr personelin e organizatës;
- Mbikëqyr organizimin e procedurës së ankesave, takimeve, konferencave dhe programeve tjera të Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës;
- Implementon vendimet e Kuvendit të KMSHK-së;
- Mbikëqyr përgatitjen e formatit të vendimeve që merr Kuvendi i KMSHK-së;
- Merr pjesë në mbledhjet e Kuvendit të KMSHK-së dhe raporton para Kuvendit sa herë që ftohet;
- Përgatit rregullat e procedurës së ankesave,
- Mbikëqyr çështjet financiare dhe procedurat administrative në bashkëpunim me Zyrtarin për ankesa/Menaxherin e administratës;
- Përgatit raportin financiar dhe i propozon buxhetin Kuvendit të KMSHK-së;
- Raporton mbi aktivitetet e Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës sipas kërkesës dhe zhvillon strategji përcjellëse;
- Siguron publikimin e vendimeve nga Kuvendi i KMSHK-së në ueb faqen e KMSHK-së;
- Rekruton personel në KMSHK sipas kërkesës;
- Identifikon burime donatorësh për të siguruar ekzistencën dhe punën e KMSHK-së, si dhe ndërlidhet me partnerë dhe financues;
- Koordinon dhe implementon fushata për informim publik dhe avokim të KMSHK-së;
- Kryen detyra tjera sipas kërkesës së Kuvendit dhe pozitës së punës që mban;

Kualifikimet dhe kërkesat specifike:

- Të ketë shkollim universitar;
- Të ketë përvojë pune menaxheriale së paku tri vjet (e preferueshme në organizata që kanë punuar me fonde);
- Të ketë shkathësi organizative dhe administrative;
- Përvojë menaxhimi, mbikëqyrjeje dhe në gjenerimin e fondeve;
- Të jetë i informuar mirë me punën e medias, përvoja në gazetari do të ishte e mirëseardhur;
- Shkathësi të dëshmuar dhe vullnet për të punuar me njerëz të kulturave të ndryshme me pikëpamje të ndryshme politike, gjinore e religjioze, duke e mbajtur njëkohësisht paanshmërinë dhe objektivitetin;
- Flexibilitet dhe mundësi për të punuar nën presion dhe me afate të kufizuara kohore;
- Shkathësi dhe aftësi për punë në kompjuter dhe online;
- Të jetë i/e rrjedhshëm/me në të shkruar dhe folur në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.

Të interesuarit, CV-në dhe një letër motivuese mund t'i dorëzojnë në adresën: Sheshi Edith Durham, 23/5 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës apo nëpërmjet e-mailit: presscouncil.kosovo@gmail.com me tekstin APLIKACION më së largu deri më 12 mars 2020.

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës është një organizatë me mundësi të barabarta dhe i inkurajon kandidatët nga minoritetet etnike dhe gratë që të aplikojnë. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen për intervistë.

C.nr.689/2019

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, i përbërë nga gjyqtari i vetëm **Betim Behluli**, në çështjen juridike të paditësve Avdi Lushi dhe Hamdi Lushi që të dytë nga fshati Radostë, komuna e Rahovecit, të cilët i përfaqëson përfaqësuesi i autorizuar avokati Labinot Vata nga Prishtina, kundër të paditurit Gjuro Toma Martinoviq me adresë të panjohur, për shkak të fitimit të pronësisë, me datë, **02.03.2020**, merr këtë:

AKTVENDIM

Të paditurit Gjuro Toma Martinoviq, tani në adresë të panjohur, **I CAKTOHET** përfaqësuesi i përkohshëm avokat Florid Hasku nga Rahoveci.

Në kuptim të nenit 82 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), përfaqësuesi i përkohshëm i ka të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjor, të cilat i ushtron deri sa të paraqitet në gjykatë i padituri apo përfaqësuesi i tij me prokurë, gjegjësisht derisa organi i kujdestarisë ta njoftoj gjykatën se e ka caktuar kujdestarin.

Ky aktvendim do të shpallet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në një nga gazetat e përditshme ditore, si dhe në tabelën e shpalljeve të gjykatës.

Arsyetim


Paditësit Avdi Lushi dhe Hamdi Lushi që të dytë nga fshati Radostë komuna e Rahovecit, të cilët i përfaqëson përfaqësuesi i autorizuar avokati Labinot Vata nga Prishtina, kundër të paditurit Gjuro Toma Martinoviq me adresë të panjohur, për shkak të fitimit të pronësisë.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësve avokati Labinot Vata me parashtrësë të datës 13.01.2020, ka kërkuar nga gjykata që të paditurit t'i caktojë një përfaqësues të përkohshëm që i njëjti t'i mbrojë të drejtat deri sa të paraqitet në gjykatë vetë i padituri respektivisht deri sa organi i kujdestarisë ta njoftoj gjykatën për caktimin e kujdestarit, pasi që për të paditurin nuk ka informacion dhe nuk ka asnjë adresë se ku mund të gjendet.

Duke vendosur sipas kërkesës të përfaqësuesit të autorizuar të paditësve, gjykata gjcti se janë plotësuar kushtet nga neni 79.3 të LPK-së, për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm të paditurit dhe se përfaqësuesi i përkohshëm avokati Florid Hasku nga Rahoveci, është pajtuar që ta përfaqësojë të paditurin e lartcekur në këtë çështje juridiko - civile.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC,
C.nr.689/2019, me datë 02.03.2020



UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi, lejohet ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit. Ankesa ushrohet përmes kësaj gjykatë, për gjykatën e Apelit, Divizioni Civil në Prishtinë.

C.nr: 689/2019

THE BASIC COURT IN GJAKOVA – BRANCH IN RAHOVEC, The General Department - Civil Division composed from by the single judge Betim Behluli in the juridical matter of the plaintiffs Avdi Lushi and Hamdi Lushi both of them from the village of Radoste, Rahovec municipality, that are represented by their authorised representative Attorney at Law Labinot Vata from Prishtina against the respondent Gjuro Toma Martinovic with an unknown address, due to establishment of ownership, on the date of 02.03.2020 renders the following:

DECISION

To the respondent Gjuro Toma Martinovic with an unknown address **IS APPOINTED** a temporary representative Attorney at Law Florid Hasku from Rahovec.

In the sense of article 82 of the Law on Contested Procedure the temporary representative has all of the rights and obligations of a legal representative which he will exercise until the respondent himself or his authorised representative appears at the court, precisely until the custody institution informs the court that a custody officer has been appointed.

This decision shall be published at the Official Gazette of the Republic of Kosovo, in one of the daily newspapers of Kosovo and at the notification board of the court.

Reasoning

The plaintiffs Avdi Lushi and Hamdi Lushi both of them from Radoste village of Rahovec municipality that are represented by the authorised representative Attorney at Law Labinot Vata from Prishtina against the respondent Gjuro Toma Martinovic with an unknown address due to the establishment of ownership.

The authorised representative Attorney at Law Labinot Vata with the submission of the date of 13.01.2020 has requested from the court that the court appoints a temporary representative to the respondent so this authorised representative shall protect the rights of the respondent until the respondent himself, the authorised representative of the respondent or the custodian institution appoints a custodian, since for the respondent there is no information and there is no address where he could be found.

Having decided as per the request of the authorised representative of the plaintiff, the court found that the conditions from Article 79 paragraph 3 of the Law on Contested Procedure have been fulfilled for the appointment of the temporary representative and that the temporary representative Florid Hasku from Rahovec has agreed to represent the above mentioned respondent in this civil juridical matter.

As mentioned above the decisions was rendered in accordance with the enacting clause.

THE BASIC COURT IN GJAKOVA – BRANCH IN RAHOVECE
C.nr: 689/2019 dated 02.03.2020

Judge
Betim Behluli

Legal Advice: An appeal against this decision is allowed within a period of 15 days from the day of its receiving. The appeal shall be submitted through this court to the Appellate Court the Civil Division in Prishtina.



SH.E
02/03/2020
Shkumbin Elshani



SHPALLJE PËR VEND TË LIRË TË PUNËS

Titulli: Zyrtar për integrim evropian dhe bashkëpunim ndërkombëtar
Njësia: Divizioni për bashkëpunim ndërkombëtar dhe integrim evropian
I raporton: Udhëheqësit të divizionit të integrimi evropiane
Grada: 6

Përmbledhje e detyrave dhe përgjegjësi:

- Ndihmon në koordinimin e çështjeve që kanë të bëjnë me integrimi evropiane e që ndërlidhen me sferën e përgjegjësi dhe detyrave të BQK-së.
- Ndihmon në përgatitjen e raporteve dhe informatave relevante për proceset e integrimit evropian konform kërkesave dhe procedurave të përcaktuara nga BQK-ja, Ministria e Integrimit Evropian dhe institucionet tjera relevante (raportimet në baza të rregullta dhe sipas nevojës).
- Me autorizim të mbikëqyrësit mban kontakte të rregullta/vazhdueshme me njësitë organizative relevante në BQK më qëllim të adresimit efikas të çështjeve që dalin nga procesi i integrimit evropian.
- Ndihmon në evidentimin e sfidave që dalin nga raportet e vlerësimit të UE-së për vendin dhe kontribuon në adresimin efikas të tyre më qëllim të tejkalimit apo përmbushjes.
- Me autorizim të mbikëqyrësit mban kontakte të rregullta/vazhdueshme me zyrtarët relevant të Ministrisë së Integrimit Evropian.
- Me autorizim nga mbikëqyrësi merr pjesë në takime të ndryshme brenda dhe jashtë vendit ndërlidhur me sferën e integrimi evropiane (seminare, takime të rregullta, raportimet e rregullta dhe punëtori).
- Me autorizim nga mbikëqyrësi merr pjesë në takimet e Komisionit për integrimi evropiane në BQK dhe kontribuon në organizimin dhe mbarëvajtjen e takimit konform kërkesave të kryesuesit të Komisionit.
- Kontribuon në mbajtjen e kontaktit me institucione tjera publike për fushat me interes të përbashkët nga sfera e integrimit evropian.
- Me autorizim nga mbikëqyrësi merr pjesë në koordinim dhe mbarëvajtje të punëve lidhur me sferën e integrimi evropiane dhe atë si në relacion me njësitë organizative brenda BQK-së ashtu edhe me institucionet tjera relevante (Ministria e Integrimit Evropian, Zyra e Komisionit Evropian dhe institucione tjera).
- Sipas kërkesës së mbikëqyrësit kryen punë tjera në kuadër të departamentit.

Njohuri e kërkuar:

- Diplomë universitare në fushën e ekonomisë, drejtësisë marrëdhënie ndërkombëtare, integrimi evropiane ose të ngjashme.
- Njohuri të mirë në të kuptuarit e funksionimit dhe zhvillimit ekonomik me fokus sistemin financiar në Kosovë dhe proceseve integruese.
- Njohja e gjuhës shqipe dhe/apo serbe, e preferuar njohja e gjuhës angleze;
- Njohuri të mirë të punës me kompjuter si Excel, Word, Power Point, Access;
- Aftësi për të krijuar dhe mbajtur komunikim dhe marrëdhënie efikase ekipore në ambient ekipor, me përbërje ndër-institucionale;
- Përkushtim për kualitet në punë dhe aftësi për të punuar nën presion.

Përvoja e kërkuar:

- Përvojë prej së paku dy (2) viteve me fokus në fushën e integrimi evropiane, bashkëpunimin ndërkombëtar apo të ngjashme që lidhen me fushat financiare.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës të lëshuar nga institucioni/organizata kompetente e mbështetur me dëshmi nga Trust apo ATK;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura/nostifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin dhe vendbanimin e përhershëm në Kosovë.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **16 mars 2020**.
- Aplikimi mund të bëhet on-line (<https://hris.bqk-kos.org>;) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së, nr:8. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org;
- Dokumentacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh.



OGLAS ZA SLOBODNO RADNO MESTO

Naslov: Službenik za evropske integracije i međunarodnu saradnju
Jedinica: Divizija za međunarodnu saradnju i evropske integracije
Izveštava: Rukovodiocu Divizije za evropske integracije
Koeficijent: 6

Opis dužnosti i odgovornosti:

- Pomaže u koordinaciji pitanja koja se odnose na evropske integracije u vezi sa oblastima odgovornosti i dužnosti CBK-a.
- Pomaže u pripremi izveštaja i informacija relevantnih za procese evropskih integracija u skladu sa zahtevima i procedurama koje su postavili CBK, Ministarstvo za evropske integracije i druge relevantne institucije (redovno izveštavanje i po potrebi).
- Uz ovlašćenje nadzornika, održava redovne/stalne kontakte sa relevantnim organizacionim jedinicama u CBK-u, u cilju efikasnog rešavanja problema koji proizilaze iz procesa evropskih integracija.
- Pomaže u identifikaciji izazova koji proizilaze iz izveštaja o proceni EU-a o zemlji i doprinosi njihovom efikasnom rešavanju u cilju prevazilaženja ili ispunjavanja istih.
- Uz ovlašćenje nadzornika, održava redovne/stalne kontakte sa relevantnim zvaničnicima Ministarstva za evropske integracije.
- Uz ovlašćenje nadzornika, učestvuje u raznim sastancima u zemlji i inostranstvu u vezi sa oblastima evropskih integracija (seminari, redovni sastanci, redovna izveštavanja i radionice).
- Uz ovlašćenje nadzornika, učestvuje na sastancima Komisije za evropske integracije u CBK-u i doprinosi organizaciji i napretku sastanka u skladu sa zahtevima predsedavajućeg Komisije.
- Doprinosi održavanju kontakta sa drugim javnim institucijama u oblastima od zajedničkog interesa u oblasti evropskih integracija.
- Uz ovlašćenje nadzornika učestvuje u koordinaciji i napretku rada u oblasti evropskih integracija i u vezi sa organizacionim jedinicama unutar CBK-a kao i drugim relevantnim institucijama (Ministarstvo za evropske integracije, Kancelarija Evropske komisije i druge institucije).
- Na zahtev nadzornika izvršava druge dužnosti u odeljenju.

Potrebno znanje:

- Univerzitetska diplomu iz oblasti ekonomije, prava, međunarodnih odnosa, evropskih integracija ili slično.
- Dobro poznavanje i razumevanje funkcionisanja i ekonomskog razvoja sa fokusom na finansijski sistem na Kosovu i integracione procese.
- Poznavanje albanskog i/ili srpskog jezika, poželjno poznavanje engleskog jezika;
- Dobro poznavanje rada sa računarom kao što su Excel, Word, Power Point, Access;
- Sposobnost stvaranja i održavanja komunikacije i efikasnih timskih odnosa u timskom okruženju sa među-institucionalnim sastavom;
- Posvećenost kvalitetnom radu i sposobnost rada pod pritiskom.

Potrebno radno iskustvo:

- Iskustvo od najmanje dve (2) godine sa fokusom u oblasti evropskih integracija, međunarodne saradnje ili slično povezane sa finansijskim oblastima.

Svi kandidati trebaju dostaviti sledeća dokumenta:

- Zvanični obrazac prijave CBK-a;
- Propratno (motivaciono) pismo kojim se izražava interes za ovu poziciju;
- Dokaz o radnom iskustvu izdat od nadležne institucije/organizacije potkrepljen dokazima iz Trust-a ili PAK-a;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti zvanično priznate /nostifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu i stalnom prebivalištu na Kosovu.

Postupak podnošenja prijave:

- Krajnji rok za podnošenje prijave je **16. mart 2020. godine**.
- Prijava se može podneti online (<https://hris.bqk-kos.org>) putem zvanične internet stranice CBK-a ili putem arhive CBK-a, br: 22; Nijedan drugi obrazac prijave neće biti razmatran.
- Obrazac prijave možete preuzeti na zvaničnoj internet stranici: www.bqk-kos.org
- Nekompletna dokumentacija neće se razmatrati.



Në pajtim me nenin 38 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), Paneli për përzgjedhjen e anëtarëve joekzekutiv të Bordit të BQK-së, publikon:

Shpallje

Për plotësimin e dy pozitave të anëtarëve joekzekutivë të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Profili i kërkuar:

- Person me integritet dhe përgatitje universitare;
- Minimum dhjetë (10) vite përvojë profesionale ose akademike në fushat e ekonomisë, financave, bankave, kontabilitetit apo çështjeve juridike;
- Njohuri në krijimin dhe monitorimin e zbatimit të politikave të rëndësishme të lidhura me misionin, objektivat dhe detyrat e BQK-së;
- Në mënyrë specifike të plotësojnë kushtet sipas nenit 40 të Ligjit nr. 03/L-209 për BQK-në;
- Njohja e gjuhës angleze dhe gjuhëve tjera paraqet përparësi.

Emërimi do të jetë për një mandat pesëvjeçar duke filluar nga data e emërimit.

Lista e kandidatëve që kualifikohen nga Paneli do t'i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës, i cili do të përzgjedhë nga një individ për secilën pozitë. Miratimi dhe emërimi për këto pozita do të bëhet nga Presidenti i Republikës së Kosovës në pajtim me nenin 84 paragrafi 27, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 38 paragrafi 2 të Ligjit nr. 03/L-209 për BQK-në.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë një CV me detaje dhe një letër motivuese përmes email adresës vijuese: paneli@bqk-kos.org ose në dorë në zarf të mbyllur në arkivin e BQK-së, Rruga Garibaldi nr. 33 në Prishtinë, ose përmes postës në adresë të BQK-së: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (shënim: për pozitën e anëtarit joekzekutiv të Bordit të BQK-së), Rruga Garibaldi nr. 33,1000 Prishtinë, Kosovë.

Afati i fundit për aplikim është 18 mars 2020, në orën 16:00.

Vetëm kandidatët e të cilët i plotësojnë kushtet e konkursit do të thirren për intervistë.



PLOTËSIM NDRYSHIM PËR VEND TË LIRË TË PUNËS

Titulli: Statisticient i ri
Departamenti: i Statistikës
Grada: 7
Raporton tek: Drejtori i departamentit të statistikës

Me efekt nga data 3 mars 2020, konkursi i shpallur me datë 29 shkurt 2020 për pozitën Statisticient i ri përgjegjës për normat e interesit, është korrigjuar për të përmirësuar një lëshim teknik.

Statisticienti i ri raporton tek "Drejtori i departamentit" e jo tek "Udhëheqësi i divizionit të bilancit të pagesave/Departamenti i statistikës".

IZMENE I DOPUNE ZA SLOBODNO RADNO MESTO

Naslov: Novi statističar
Departman: za statistiku
Koeficijent: 7
Izveštava: Direktor Departmana za statistiku

Sa dejstvom na dan 3. mart 2020. godine, raspisani konkurs od 29. februara 2020. godine za poziciju Novi statističar za kamatne stope, korigovan je za ispravku tehničke greške.

Novi statističar izveštava „Direktoru departmana“ a ne „Rukovodiocu Odeljenja za platni bilans/Departman za statistiku“



U skladu sa članom 38. Zakona br. 03/L-209 o Centralnoj banci Republike Kosovo (CBK), Panel za izbor neizvršnih članova Odbora CBK-a, objavljuje:

Oglas

Za popunjavanje dve pozicije neizvršnih članova Odbora Centralne banke Republike Kosovo

Potreban profil:

- Osoba sa integritetom i univerzitetskom spremom;
- Minimalno deset (10) godina profesionalnog ili akademskog iskustva u oblastima ekonomije, finansija, bankarstva, računovodstva ili pravnih pitanja;
- Znanje u kreiranju i praćenju sprovođenja važnih politika koje se odnose na misiju, ciljeve i zadatke CBK-a;
- posebno, ispunjavanje zahteva iz člana 40. Zakona br. 03/L-209 o CBK-u;
- Poznavanje engleskog i drugih jezika je prednost.

Imenovanje će biti za mandat od pet godina, počevši od dana imenovanja.

Lista kandidata koji se kvalifikuju od strane Pancla biće poslata Skupštini Republike Kosovo, koju će izabrati po jednog pojedinca za svaki položaj. Predsednik Republike Kosovo odobrava i imenuje ove položaje u skladu sa članom 84. stav 27. Ustava Republike Kosovo i članom 38. stav 2. Zakona br. 03/L-209 o CBK-u.

Zainteresovani kandidati treba da dostave CV sa detaljima i propratnim pismom na sledeću e-mail adresu: paneli@bqk-kos.org ili lično u zapečaćenoj koverti u arhivi CBK-a, ulica Garibaldi br. 33 u Prištini, ili putem pošte na adresu CBK: Centralna banka Republike Kosovo (napomena: za položaj neizvršnog člana Odbora CBK), ulica Garibaldi br. 33,1000 Priština, Kosovo.

Krajnji rok za prijavu je 18. marta 2020. godine u 16:00 časova.

Samo kandidati koji ispunjavaju uslove konkursa biće pozvani na intervju.



Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës – Ministarstvo Inistranij Poslova i Dijaspore – Ministry of Foreign Affairs and Diaspora

Datë: 02.03.2020

Njoftim për Anulimin e konkursit

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës njofton të gjithë kandidatët të cilët kanë aplikuar në konkursin e shpallur me datë: 24.01.2020, për pozitën: Drejtor i Departamentit të Protokollit të Shtetit, për arsye objektive bën anulimin e pozitës së cekur. Pozita e anuluar do të rishpallet, posa të krijohen kushtet e nevojshme të cilat kanë ndikuar në anulimin e konkursit.

Ju faleminderit për mirëkuptim!

Obaveštenje o poništenju konkursa

Ministarstvo Inostranih Poslova i Dijaspore obaveštava kandidate koji su se prijavili za raspisani konkurs, 24.01.2020. godine, za poziciju : Direktor Departmana državnog protokola, zbog objektivnih razloga poništava navedeni konkurs za te pozicije. Poništene pozicije će se ponovo raspisati, čim se budu stvorili potrebni uslovi koji su uticali u poništenju konkursa.

Hvala vam na razumevanju!



AUTOSHKOLLA RITMI

044 248 173
045 626 123
044 648 122

PRISHTINË

autoshkollaritmi@gmail.com



Në prag të 5, 6, 7 dhe 8 Marsit ditëve të lavdisë dhe sakrificës së familjes Jasharaj, ditës së mësuesit dhe ditës së nënës, për kandidat/etë interesuar për regjistrim të marrjes së patentë shoferit ofroj lehtësim financiar. **Vijimi i orëve praktike dhe teorike për 20 ore nga 200.00 Euro në 150.00 Euro.**

Interesimi i juaj - përkushtimi ynë. Eksperienca jonë - suksesi i juaj. Afati i paraqitjes prej 02.03. 2020 deri më 20.03.2020

